

**Komuna e Gjilanit**  
**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim**

**VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË  
NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR  
KOMUNËN E GJILANIT**





**PËRMBAJTJA****PËRMBAJTJA**

Parathënie.....	9
Themelimi i GP .....	10
Hyrje.....	11
Misioni dhe synimi i vlerësimit të rrezikshmërisë.....	12
Infrastruktura Ligjore.....	12

**Kreu I**

Profili i Komunës.....	13
Pozita, karakteristikat gjeografike dhe klimatike të komunës.....	13
Lagjet urbane në qytetin e Gjilanit.....	13
Fshatrat e komunës së Gjilanit.....	14
Zona e përgjegjësisë - përkufizimi hapësinor.....	15
Hidrografia – Lumenjtë dhe liqenet.....	18
Gjatësia e rrjetit të lumor që përshkon territorin e komunës së Gjilanit.....	18

**Demografia**

Popullsia e Komunës së Gjilanit sipas gjinisë dhe etnive 2011.....	20
Popullsia sipas tipit të vendbanimit, gjinisë dhe kontingjenteve themelore 2011.....	20
Gjithsej popullsia e komunës së Gjilanit e vlerësuar për vitin 2021.....	20
Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim.....	21
Pensionistët - Të papunët - Asistenca sociale.....	22

**Të mirat materiale, kulturore dhe të mjedisit**

Trashëgimia kulturore .....	23
Asetet e trashëgimisë natyrore nën mbrojtje.....	24
Asetet e trashëgimisë natyrore.....	24
Asetet e Trashëgimisë Kulturore.....	24
Lokacioni i monumenteve kulturore.....	25
Lokacioni i monumeneve arkeologjike dhe vendbanimet arkeologjike .....	26
Asetet e Trashëgimisë Natyrore.....	28
Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore .....	29
Biogjeografia dhe biodiversiteti.....	31
Zoodiversiteti dhe fitodiversiteti.....	31

**Zonat e prodhimit bujqësor.**

Toka bujqësore sipas pronësisë.....	33
Prodhimtaria bujqësore.....	33
Sipërfaqet pyjore.....	35
Zonat industriale dhe objektet ekonomike.....	37
Vendndodhja dhe veçoritë e zonës industriale .....	37
Agrobiznesi .....	38
Turizmi.....	38

<b>Objektet e banimit</b> .....	39
Banesat sipas llojit, statusit të shfrytëzimit dhe tipit të vendbanimit.....	40
Numri i objekteve sipas funksionit dhe banesat në të cilat ushtrohet veprimtaria afariste.....	41
<b>Objektet sportive.</b>	
Institucionet sportive, kapacitetet hapësinore dhe profesionale - kapacitetet infrastrukturore ...	42
<b>Strehimoret dhe objektet për strehim</b> .....	43
Lokacionet – zonat e grumbullimit në rast fatkeqësie.....	45
<b>Institucionet Shëndetësore.</b>	
Kapacitetet humane shëndetësore .....	48
Kapacitetet teknike në sektorin publik (QKMF/QMF).....	49
Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente: .....	50
Spitali regjional i Gjilanit.....	51
Të punësuarit sipas nivelit profesional.....	51
<b>Infrastruktura teknologjike dhe e trafikut.</b>	
Rrugët – Autoudha - Rrugët nacionale.....	56
Rrugët Regjionale - Rrugët lokale (urbane).....	57
Gjendja e udhëkryqeve.....	58
Gjendja e Transportit Publik dhe Mirëmbajtja e Rrjetit Rrugor.....	59
Ngarkesa e trafikut.....	60
Siguria në trafik.....	62
Hekurudhat.....	64
Aeroportet.....	64
Urat dhe tunelet.....	65
.	
<b>Largpërçuesit dhe trafo-stacionet.</b>	
Sistemet energjetike ( objektet dhe sistemet).....	72
<b>Qendrat telekomunikuese,</b>	
Telefonia mobile - rrjeti kabllorik- TV dhe radiostacionet – radiokomunikimi.....	73
<b>Objektet dhe shërbimet brenda komunës</b> .....	74
<b>Sistemet hidroteknike</b>	
Objektet për furnizim me ujë.....	75
Rezervuarët e ujit.....	76
Stacionet e Pompimit dhe Rrjeti i Ujësjiellit.....	77

**Mirëmbajtja – Ekohigjiena**

Tipologjia e ofrimit të shërbimit.....82

**Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës .**

Pompat e derivateve;.....83

**OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË**

Objektet e sigurisë - stacionet policore, qendrat operative rajonale.....87

Objektet dhe hapësirat qeveritare .....87

Shërbimet financiare - bankat, agjencitë e sigurimeve, shërbimet postare .....88

**Objektet shkollore**

Infrastruktura shkollore: Çerdhet e fëmijëve, Shkollat e mesme.....89

Shkollat fillore.....90

Çerdhet private – shkollat private - universiteti.....91

**KREU II-të**

Fatkeqësitë natyrore .....92

Intensiteti, llojet dhe ndikimet e veprimit të fatkeqësive .....93

Vërshimet - Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet.....93

Karakteristikat hidrografike - Historiku, koha, pikat e nxehta);.....94

Vendet – vendbanimet e atakuara .....95

Kushtet hidrometeorologjike.....98

Të dhënat për disa parametra klimatik për komunën e Gjilanit .....98

Sasia e reshjeve në mm, sipas stinëve të vitit në Gjilan.....98

Rastisja dhe shpejtësia e Erës për Gjilanin.....98

Masat parandaluese; .....99

Masat e ndërmarra parandaluese - rekomandimet.....108

**ZJARRET**

Kushtet klimatike - Intenziteti, shpeshësia e paraqitjes, kohë-zgjatja dhe historiku.....109

Struktura dhe numri i zjarreve 2012 – 2022 dhe Sipërfaqet e rrezikuara .....110

Masat parandaluese për zjarret.....112

Masat parandaluese për zjarret industriale.....112

**TËRMETET**

Karakteristikat sizmike të zonave, rreziku sizmik, shpeshësia, intensiteti dhe epiqendra.113

Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve.....113

Rrezikshmëria e zonave të caktuara.....118

Masat parandaluese.....120

**KRËSHQITJET DHE EROZIONET**

Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve.....	122
Rrëshqitja e tokës .....	112
Sipërfaqet e përfshira dhe Masat parandaluese për erozionin.....	112

**BRESHËRI**

Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri.....	124
Pasojat nga breshëri.....	125
Shpeshësia e paraqitjes dhe muajt kritik.....	125
Masat parandaluese për shtrëngata dhe breshër.....	125

**ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË**

Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale.....	126
Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve....	126
Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë.....	126
Harta e historikut të goditjes së erës në komunën e Gjilanit.....	128
Masat parandaluese.....	128

**THATËSIRAT**

Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike.....	130
Rezervuarët e ujit - Masat parandaluese.....	131

**RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË**

Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale.....	132
Situata epidemiologjike në komunën e Gjilanit karakterizohet.....	132
Sëmundjet ngjitëse në komunën e Gjilanit.....	133
Pandemia COVID – 19, historiku.....	133
Mësimet e mësuara nga menaxhimi i pandemisë CIVID – 19.....	135

**FATKEQËSITË TJERA**

Liqeni akumulues i Përlepticës.....	137
Skenari për pasojat nga shpërthimi eventual i digës hidro-akumuluese.....	138
Liqeni akumulues i Livoçit.....	141

**STRUKTURAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM**

Njësa Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.....	143
Shoqata e Vullnetarve të Zjarrfiksave.....	143
Konvikti i studentëve.....	143
Klubet alpiniste.....	143
Kryqi i kuq i Kosovës – Gjilan.....	144

VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE –SPECIFIKE.....	145
--	-----

KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT.....	145
--	-----

---

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE .....	146
REKOMANDIME: .....	147

**SKENARET****Vërshim**

Skenari I, i nivelit të ulët.....	147
Skenari II, i nivelit të mesëm.....	158
Skenari III, i nivelit katastrofë.....	170

**Zjarre**

Skenari I, zjarr malor, skenar i ulët.....	181
Skenari II, zjarr fusho, skenar i mesëm.....	191
Skenari II, zjarr industrial, skenar katastrofë.....	203

**Shtrëngatë**

Skenari i mesëm.....	213
----------------------	-----

**Tërmet**

Skenari I i nivelit të ulët.....	225
Skenari II, i nivelit të mesëm.....	235
Skenari III, i nivelit katastrofë.....	245





## PARATHËNIE

Hartimi i dokumenteve strategjike të komunës siç janë “Vlerësimi i Rrezikut” dhe “Plani Operativ Emergjent”, janë dokumente bazike për menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive tjera, të cilat i parasheh korniza ligjore dhe rregullative. Në këtë kuadër, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH), si institucioni bartës i këtyre aktiviteteve, ka iniciuar procesin për rifreskimin e dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera. Në këtë proces, së pari, është kontaktuar Agjencia i Menaxhimit të Emergjencave (AME), nga ku janë kërkuar sugjerimet e nevojshme që ky proces të përfundoj sipas procedurave të parapara me ligj dhe me udhëzime administrative dhe rregulloreve (Rregullore (QRK) Nr.25/2020, për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmëri).

Nga AME, janë marrë udhëzimet e nevojshme, metodologjia, si dhe formati standard mbi bazë të cilit duhet të hartohet ky dokument, për të përmbushur standardet e një dokumenti bazë për hartimin e dokumenteve në fushën e menaxhimit të situatave emergjente, por, edhe si bazë e nevojshme për sektorët komunal në fushën e planifikimeve urbanistike dhe në atë të infrastrukturës së përgjithshme dhe asaj kritike.

Së dyti, duke vepruar mbi udhëzimet nga AME, kryetari komunës, ka marr vendim me të cilin është themeluar Grupi Punues, i cili është gjithëpërfshirës në aspektin profesional për të përmbushur standardet e nevojshme që dokumenti të fitoj validitetin nga organet kompetente. Me qëllim të familjarizimit me materien të Grupit Punues, DMSH dhe AME kanë organizuar një punëtori dyditore, ku janë dhënë shpjegimet bazike për procesin dhe metodologjinë e hartimit të dokumentit.

Grupi ka filluar punën sipas sektorëve, ku DMSH si bartëse e aktivitetit ka grumbulluar të dhënat e nevojshme, të cilat i ka sistemuar sipas kriterëve të përcaktuar dhe ka realizuar draftin e parë, të cilin ja ka dërguar sektorit përkatës të AME, për t’i dhenë komentet. Pas marrjes së komenteve, janë bërë plotësimet e nevojshme, ku drafti i është dërguar AME përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal. Pas marrjes së miratimit, drafti është hedhë në shqyrtim publik dhe pas plotësimeve të nevojshme është dërguar për miratim në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, ku pas shqyrtimit nga komisionet përkatëse me datë \_\_\_\_\_ është miratuar.

## THEMELIMI I GRUPIT PUNUES

Kryetari i komunës së Gjilanit z.Alban Hyseni bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë brenda juridiksionit komunal, me 27.05.2020, nxjerrë vendimin nr 471, për themelimin e Grupit Punues, për hartimin /rishikimin e dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut.

Anëtarët e grupit janë:

- |                          |                       |
|--------------------------|-----------------------|
| 1. Bejtullah Osmani;     | 14. Doruntinë Hasani; |
| 2. Ahmet Daku;           | 15. Bekim Salihu;     |
| 3. Hazir Mustafa;        | 16. Sali Mustafa;     |
| 4. Fadil Kajtazi;        | 17. Agim Lipovica;    |
| 5. Mentor Mihovci;       | 18. Rabbit Murseli;   |
| 6. Riad Rashiti;         | 19. Ilmi Shala;       |
| 7. Ali Arifi;            | 20. Ibrahim Tahiri;   |
| 8. Aurora Osmani – Buca; | 21. Muhamet Syliqi;   |
| 9. Bajram Isufi;         | 22. Senad Rama;       |
| 10. Selvete Sylejmani;   | 23. Ali Rexhepi;      |
| 11. Entela Hyseni;       | 24. Jahir Kërqeli;    |
| 12. Kushtrim Zeqiri;     | 25. Fehmi Mustafa.    |
| 13. Enver Shabani;       |                       |

**Grumbullimi i informacioneve, seleksionim, radhitja, dizajni dhe redaktimi:**

1. Bejtullah Osmani;
2. Fadil Kajtazi;
3. Ahmet Daku.

**Përpunimi i hartave:**

1. MSc. Amir Rexha;
2. Fadil Kajtazi.

## H Y R J E

*“Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën sasiore dhe cilësore të fatkeqësive të shkaktuara nga fenomenet natyrore, proceset teknologjike dhe rrethanat e caktuara tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ”*

Si çdo pjesë e Kosovës edhe komuna e Gjilanit mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore. Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, në të kaluarën ka pasur fatkeqësi, të cilat kanë shkaktuar viktima, dëmtuar të mirat materiale, trashëgimisë kulturore dhe ambientit. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut nga **Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera**.

Rreziku ndër të tjera paraqet një përjetim të humbjes apo dëmit, i cili mund të shfaqet në cilin do vend dhe në çfarëdo kohë, intensiteti i të cilit mund të jetë i kufizuar apo me përmasa tragjike, prandaj, parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nënkupton zvogëlimin – lehtësimin e rreziqeve, masat parandaluese, ngritjen e nivelit të gatishmërisë dhe kapaciteteve të nevojshme, për të ndërmarrë veprimet e duhura në situata emergjente.

Ky dokument është bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Komuna e Gjilanit është përgjegjëse për organizimin e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera në kufijtë territorial të përgjegjësisë të saj, si pjesë e sistemit unik të emergjencave civile në Kosovë, i cili përmban planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe financimin e të gjitha masave dhe aktiviteteve për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë duhet të rishikohet sipas rregullores në fuqi çdo tri vite e në raste sepcifike edhe më herët.

## MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë konsiston në identifikimin, analizimin, vlerësimin, strukturimin dhe arkivimin e informatave nga të gjitha subjektet juridike pjesëmarrëse dhe reaguese ndaj situatave emergjente në komunë, me qëllim të:

- a. Hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera përkatëse sipas legjisllacioneve në fuqi;
- b. Profilizimit dhe standardizimit të masave parandaluese dhe veprimeve konkrete për zvogëlimin, zbutjen dhe sanimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- c. Caktimit të shkallës së cenueshmërisë (vatrave potenciale të rrezikut sipas shkallës së rrezikshmërisë), përcaktimit të moduleve vlerësuese për situatat e krijuara emergjente si dhe koordinimit të resurseve humane dhe teknike, të cilat do të përfshihen si përgjigje adekuate në situatat emergjente;

Vlerësimi i rrezikut nënkupton procesin e analizimit, vlerësimit dhe konkluzioneve të cilat inkorporohen në hartimin e planeve dhe strategjive afatshkurtëra dhe afatgjate, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT, realizimin e projekteve konkrete dhe menaxhimin e situatave emergjente me të cilat mund të përballet komuna.

## INFRASTRUKTURA LIGJORE

Hartimi i “Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera“, për territorin e komunës së Gjilanit, është i bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent dhe planeve tjera.

Vlerësimi i Rrezikshmërisë për territorin e komunës së Gjilanit është dokument me karakter lokal, hartimi i të cilit është i bazuar në:

1. “Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera” Nr. 04/L-027;
2. Rregullorja për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT, Nr. 25/2020;
3. Statuti i Komunës së Gjilanit.



## PROFILI I KOMUNËS SË GJILANIT

Komuna e Gjilanit përfshin një sipërfaqe prej 391 kilometra katrorë. Sipas Statutit të Komunës së Gjilanit, nenit 11, pika 2, territori i komunës si njësi territoriale përbëhet prej lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanime sipas zonave kadastrale si në tabel

Ndërsa me rregulloren për “Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Gjilanit” nr. 10/2018 është bërë rregullimi dhe ndarja e vendbanimeve të komunës si në vijim:

Qyteti i Gjilanit shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, në rajonin e Anamoravës dhe kufizohet:

- në juglindje me Preshevën (33 km) dhe Kumanovën (malet e Karadakut);
- në lindje me Bujanocin (40.5 km);
- në verilindje me Kamenicën (29 km) dhe Ranillugun,
- në jugperëndim me Parteshin dhe Vitin (20 km),
- në veriperëndim me Lipjanin.
- në veri me Novo Berden (19.5 km).

Në juglindje ka malet e Karadakut si dhe një pjesë të rrafshit të Kosovës – një fushë pjellore. Rrethinën e Gjilanit e përshkon lumi “Morava e Binçës”.

Nga kryeqyteti ka 47 km.

Mirëpo Gjilani njihet edhe si qendra e trekëndëshit të dyfishtë me të cilët trekëndësh lidhet me shtetet fqinjë, nga kjo shihet se ka një pozitë të volitshme gjeostrategjik

Lagjet urbane në qytetin e Gjilanit <sup>1</sup>	
“Arbëria”	“Iliria”
“Zabeli”	“Arbëria”
“Qendra”	Lagja “Banja ”
“Dardania 1”	“Vishnjët Gjilan ”
“Dardania 2”	“Kodra e Dëshmorëve”
“Rruga e Ferizajit”	“Deramahallë”
“Dheu i Bardhë”	

<sup>1</sup> Rregullore (KKGJ)10/2013

<b>Fshatrat e komuës së Gjilanit</b>	
<b>Pogragjë</b>	<b>Shurdhan</b>
<b>Livoq i Poshtëm</b>	Çelik
<b>Malishevë</b>	Dunav
<b>Llashticë</b>	Pidiq
<b>Velekincë</b>	Stançiq
<b>Cërnice</b>	Goden
<b>Përlepnice</b>	<b>Llovcë</b>
<b>Dobërçan</b>	Kokaj
Bukovik	Inatoc
Sllubicë	<b>Kishnapolë</b>
<b>Haxhaj</b>	Gadish
Kuregj	Sllakoc i Epërm
Terzijaj	Sllakoc i Poshtëm
<b>Kmetoc</b>	<b>Muqibabë</b>
<b>Uglarë</b>	Burincë
<b>Lladovë</b>	Lipovicë
<b>Vërbicë e Zhegocit</b>	<b>Nasal</b>
<b>Vërbicë e Kmetocit</b>	<b>Kravaricë</b>
<b>Muhagjirët e Shillovës</b>	<b>Capar</b>
<b>Malishevë e Epërme</b>	<b>Shillovë</b>
<b>Selishtë</b>	<b>Gumnishtë</b>
<b>Demiraj</b>	

Territorin e Komunës së Gjilanit e përshkon lumi Morava e Binçës, i cili mbledhë gjithë lumenjtë e vegjël, me një prurje mesatare ujore prej 6.7 m<sup>3</sup>/s.


Qyteti i Gjilanit përshkohet edhe nga tre lumenj të vegjël: Dobrusha, Stanishorka dhe Baja. Prurja maksimale e ujit të lumit Dobrusha është 0.22 m<sup>3</sup>/s, ndërsa sipërfaqja grumbulluese është 11.07 km<sup>2</sup>. Lumenjtë Stanishorka dhe Baja janë më të vegjël për nga prurja e ujit .

Lumenjtë të cilët kalojnë nëpër vendbanime në pjesët rurale siç janë: “Morava e binqës”, lumi i Livoqit, Cernicës, Bresalcit, Zhegrës, Llashticës dhe Përlepticës.

### ZONA E PËRGJEGJËSISË (PËRKUFIZIMI HAPËSINOR)

Komuna e Gjilanit kufizohet me Komunat e Kamenicës, Ranillugut, Novobërdës, Lipijanit, Ferizajit, Vitisë dhe të Parteshit.

Gjithashtu me Serbinë, komunat Bujanovc dhe Peshevë, si dhe me Republikën e Maqedonisë Veriore, komuna e Lipkovës.






### Legjenda

- Komunat e Gjilanit
- Zonat Kadastrale

Spatial Reference  
 Name: KOSOVAREF01  
 PCS: KOSOVAREF01  
 GCS: GCS ETRS 1989  
 Datum: ETRS 1989  
 Projection: Transverse Mercator

25/07/2023 3:42 PM  
 © MSc. Gjeografisë Amir REXHA

## Zonat Kadastrale në Komunën e Gjilanit








02/08/2023 3:34 PM

© MSc. Gjeografisë Amir REXHA

### Lagjet - Zona Urbane e Gjilanit





## HIDROGRAFIA -LUMENJTË DHE LIQENET

Gjatësia e rrjetit të lumor që përshkon territorin e komunës së Gjilanit			
Lumi – Përroi		Derdhja	Gjatësia në km
1	Lumi i Poneshit	Liçeni i Livoçit	9.49
2	Lumi i Bresalcit	Lumi i Poneshit	6.9
3	Lumi i Livoçit	Lumi Morava	8.51
4	Lumi i Cërnicës	Lumi Morava	16.10
5	Përroi i Vrapçiqit	Lumi i Cërnicës	7.66
6	Lumi Dobrusha	Lumi Stanishorka	7.8
7	Lumi Stanishorka	Lumi Morava	13
8	Përroi Kufcës	Lumi Stanishorka	7.7
9	Përroi i Shillovës	Lumi Stanishorka	6.24
10	Lumi i Përlepticës	Lumi Morava	9.9
11	Përroi i Kosaçës	Lumi i Përlepticës	2.78
12	Lumi i Zhegrës	Lumi Morava	13.2
13	Lumi i Sllubicës	Lumi Morava	7.86
14	Lumi Morava	Partesh - Ranillug	13.1
Gjithsej			<b>130.25</b>
Liqenet artificiale		Vendi	Kapaciteti m <sup>3</sup>
1	Liçeni i Livoçit	Livoç i epërm	1.000.000
2	Liçeni i Përlepticës	Përlepticë	4.000.000


Kompania rajonale për ujë dhe ujëra të zeza “Hidromorava” është autoriteti i vetëm përgjegjës për mirëmbajtjen dhe për furnizim me ujë të pijshëm për popullatën e Gjilanit.

Një ndër qëllimet themelore të kompanisë është të siguroj ujë të kualitetit të pijes (në marrëveshje me standardet **WHO** për ujë të pijshëm), në sasi të mjaftueshme, me presion të mjaftueshëm, pa ndërprerje dhe me çmime të arsyeshme për konsumatorin.

Kompania rajonale për ujë dhe ujëra të zeza Hidromorava për mbulimin e zonës gjeografike për të cilën është përgjegjëse shfrytëzon këto pika furnizuese me ujë:

1. Burimi: Akumulacioni në Perlepnice dhe kapaciteti i burimit 110-120 lit/sec apo 9,936 m<sup>3</sup> për 24 orë, me kapaciteti i perpunimit te ujit 200 lit/sec
2. Burimi: Guri i Hoxhes (kaptazha) në Perlepnice, kapaciteti i burimit 60-70 lit/sec, apo 5,616 m<sup>3</sup> për 24 orë, perpunimi i ujit behet ne fabriken amë te penda
3. Burimi: Baja kaptazh në Gjilan, kapaciteti i burimit 25-30 lit/sec apo 2,376 m<sup>3</sup>, për 24 orë. Kapaciteti i perpunimit te ujit 40 lit/sec uji perpunohet ne stacionin në Bajë
4. Burimi: Pellgu i lumit Morava ne Velekince, dhe kapaciteti i burimit 80 lit/sec, kapaciteti i perpunimit te ujit 80 lit/sec

Hidrografia e komunës së Gjilanit<sup>2</sup>



<sup>2</sup> Harta: Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës



## DEMOGRAFIA<sup>3</sup>

### SHPERNDARJA E FAMILJEVE NË BAZË TË GRUPEVE ETNIKE NË

#### Popullsia e Komunës së Gjilanit sipas gjinisë dhe etnive 2011

Komuna e Gjilanit	Gjinia		Etnia								
	Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptas	Goran	Të tjerë
90,178	45,354	44,824	87,814	624	978	121	361	15	1	69	95

#### Popullsia sipas tipit të vendbanimit, gjinisë dhe kontingjenteve themelore 2011

Komuna e Gjilanit	Popullsia							Popullsia e aftë për punë			
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Foshnje 0 vjeç	Fëmijë 1-6	Fëmijë 7-14	Rinia 15-27	15-64	Meshkuj	Femra	65 +
Gjith.	90.178	45.354	44.824	1.264	7.978	14.222	22.230	60.160	30.196	29.964	6.554
Urban	54.239	27.133	27.106	731	4.665	8.283	13.202	36.670	18.302	18.368	3.890
Rural	35.939	18.221	17.718	533	3.313	5.939	9.028	23.490	11.894	11.596	2.664

#### Gjithsej popullsia e komunës së Gjilanit e vlerësuar për vitin 2021

Komuna e Gjilanit Sipërfaqja në km <sup>2</sup>	Popullsia e vlerësuar 31 dheror 2020	Shtimi natyror	Bilanci i migrimeve (2021)	Rritja e Përgjithshme (shtimi natyror dhe migrimi) për vitin 2021	Popullsia e vlerësuar 31 dhjetor 2021	Numri i banorëve në 1 km <sup>2</sup>
391.89	77.145	485	- 4.112	-3.627	73.518	187.60

<sup>3</sup> Burimi: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK); Data e botimit: Dhjetor, 2022

Komuna e Gjilanit gjendet në zonën jug-lindore të Kosovës. Përfshin një sipërfaqe prej përafërsisht 391.89km<sup>2</sup> dhe përfshin qytetin e Gjilanit dhe 49 fshatra.

Sipas vlerësimit, Popullsisë të Kosovës për vitin 2020, popullsia e përgjithshme për komunën e Gjilanit është 77,145, ndersa Sipas VLERËSIMIT për vitin 2021 (31dhjetor 2021) popullsia e përgjithshme për komunën e Gjilanit është 73518

#### KATEGORITË E BANORËVE TË PLANIFIKUAR PËR EVAKUIM<sup>4</sup>

- Nënmat me fëmijë
- Nxënësit deri në 14 vjeç
- Të moshuarit mbi 70 vjeç
- Personat me nevoja të veçanta
- Aspekti gjinor, etj.

Popullsia e komunës së Gjilanit sipas gjinisë dhe grup-moshave 2011									
Komunat e Gjilanit		Gjithsej	Grup-mosha						
			0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34
	Gjithsej	90,178	6,409	7,789	9,266	9,824	8,322	6,653	6,106
	Meshkuj	45.354	3.309	4.015	4.760	5.056	4.435	3.469	3.058
	Femra	44.824	3.100	3.774	4.506	4.768	3.887	3.184	3.048
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<b>35-39</b>	<b>40-44</b>	<b>45-49</b>	<b>50-54</b>	<b>55-59</b>	<b>60-64</b>	<b>65-69</b>	<b>70-74</b>	<b>75-79</b>	<b>80+</b>
6,541	6,509	5,615	4,444	3,341	2,805	2,582	1,938	1,189	845
3.012	3.204	2.797	2.237	1.629	1.299	1.192	921	589	372
3.529	3.305	2.818	2.207	1.712	1.506	1.390	1.017	600	473

<sup>4</sup> Burimi: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK); Data e botimit: Dhjetor, 2022

**Pensionistët <sup>5</sup>**

<b>Kategoritë e pensionistëve në Komunën e Gjilanit</b>											
Pensionistët kointribues	Pensione bazë	Pens. e Personave me Aftësi të Kufizuar	FSK	Pens. Invalidor i Punës	Trepça	TMK	Pen. Paraplegjik e Tetruplegjik	Pensione familjare	Kompensime monetare	Arsimi	Totali
<b>2.117</b>	<b>9.376</b>	<b>1.215</b>	<b>25</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>24</b>	<b>132</b>	<b>146</b>	<b>137</b>	<b>703</b>	<b>13.880</b>

**Të papunët**

<b>Punëkërkesit e regjistruar sipas grupmoshave</b>			
Grup mosha	Totali	Femra	Meshkuj
15 – 24	585	279	306
5 – 39	1.337	676	661
40 – 54	962	472	490
55 +	568	256	312
<b>Totoali</b>	<b>3.452</b>	<b>1.683</b>	<b>1.769</b>

**Asistenca sociale**

<b>Nacionaliteti</b>	<b>Nr. i Familjeve</b>	<b>Nr. Ant. Familjes</b>
Shqiptar	590	90.74 %
Turk	1	0.21 %
Serb	18	2.64 %
Mysliman	/	/
Komuniteti RAE	38	6.41 %
Të tjerë	/	/
<b>Gjithsej</b>	<b>647</b>	<b>100 %</b>

<sup>5</sup> Burimi: zyra regionale Punës, Pasqyra e shfrytëzuesve në vitin 2023.



## TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT<sup>6</sup>

### Trashëgimia kulturore ( monumentet kulturore, eksponatet kulturore, objektet e kultit

Marrë në përgjithësi kushtet gjeomorfologjike të komunës janë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e saj të mëtejme. Në territorin e komunës ka pasuri të lëndëve të para, të metaleve dhe jometaleve. Një pjesë e peizazhit të hapur në komunë është në gjendje shqetësuese, si toka e rrezikuar nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave. Kjo tokë duhet urgjentisht të mbrohet sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Për ta rikthyer dhe ruajtur peizazhin, biodiversitetin dhe mjedisin jetësor edhe për gjeneratat e ardhshme, si dhe për ta mbrojtur tokën dhe burimin e ujit të pijes nga ndotjet e ndryshme, nevojitet që peizazhi të pastrohet nga hedhja ilegale e mbeturinave dhe të mirëmbahet. Më poshtë janë listuar asete të trashëgimisë natyrore nën mbrojtje:

Lokacioni	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Shpella dhe Guri i Shtrigës, Resulë, Pidiq	X	/
Gryka e Llapushnicës, Pogragjë	X	6.00
Shpella e Bresalcit	X	/

Tabela 1 Asetet e trashëgimisë natyrore nën mbrojtje

Lokacioni	Lloji
Lugina e Lumit Llapushnik	Park natyror
Burimet Hidrotermale – Kmetoc	Monument natyror
Liqeni i Përlepnicës me rrethinë	Peizazh i mbrojtur
Trungjet e dardhës së egër – Lipovicë	Monument natyror
Trungjet e bungut – Burincë	Monument natyror
Burimi i ujit termal – Uglarë	Monument natyror
Burimi i ujit termal – Gumnishtë	Monument natyror
Trungjet e bungut – Ponesh	Monument natyror
Burimi i ujit mineral – Ponesh	Monument natyror
Trungjet e bungut – Parallovë	Monument natyror
Burimi i ujit termomineral – Pidiq	Monument natyror

Tabela 2 Asetet e trashëgimisë natyrore

<sup>6</sup> Burimi: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, si dhe Qendra Regjionale e Trashëgimisë Kulturore

### Asetet e Trashëgimisë Kulturore

Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) në Gjilan është përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në Komunën e Gjilanit.

Në vitin 2002, bëhet lista e objekteve të trashëgimisë kulturore të Gjilanit për marrjen nën mbrojtje të ligjit nga Instituti për Ruajtjen e Monumenteve të Kosovës. DKRS organizon aktivitet eksplorues të trevës së Gjilanit për grumbullimin e eksponateve të luajtshme që rezulton me vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Muzeut të Qytetit (vendim ky, i cili ende nuk është zbatuar). Komuna e Gjilanit ka një thesar të çmuar të trashëgimisë kulturore, siç janë: Kalaja e Pogradjës, Kalaja e Resulës në Pidiq, Kalaja e Mireshit, Xhamia e Medresesë, Xhamia e Madhe, Xhamia në Cërnice (minarja), Mesgjidi në Lladovë, Hambari i Shukri Mahmutit në Lladovë, Koshi i Tefik Selimit në Nasalë, Xhamia në Pidiq, Xhamia në Llashticë, Dyert e oborrit të Jakup Hysenit në Llashticë, Hambari i Feriz Llashticës, Shtëpia e Ruzhdi Selimit në Llashticë, Oda e Bejtulla Selimit në Llashticë, Xhamia në Vërbicë të Zhegocit, Hani i Shefikut në Vërbicë të Zhegocit, Xhamia në Velekincë, Xhamia në Malishevë, Kisha katolike në Dunav, Themelet e Kishave katolike në shumë fshatra, Kisha ortodokse në Gjilan, Teqja e qytetit në Gjilan, Shtëpia e Zekirja Abdullahut në Gjilan, Shtëpia e Maksut Malokut në Gjilan, objekti i Depos ushtarake turke, shkolla e Muzikës (Shtëpia e Mustafë Pashës), objekti i Kajmekamit, dhe Kulla e Sahit Agës.

Në komunë shtrihen edhe monumente tjera me vlera historike, siç janë: Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve, shtatorja e Idriz Seferit, shtatorja e Rexhep Malës e Nuhi Berishës, shtatorja e Agim Ramadanit, përmendorja e Dëshmorëve të UÇK-së në Zhegoc, bustet e Skënderbeut, Esat Berishës, Halim Oranës, Xhavit Ahmetit, Muharrem Ibrahimit, Reshat Ymerit, Parku i Dëshmorëve në Mireshe, përmendorja e Abdullah Tahirit në Malishevë, busti i Musa Zajmit në Ponesh, pllaka përkujtimore e Idriz Seferit në Zhegër, kalatë në Pogradjë, Resulë (Pidiq), Tumat Ilire në Llashticë, shtëpia e Zekirja Abdullahut në Gjilan, shtëpia e Sadudin Teneqjisë në Gjilan, Arkivi Regjional, dhe përmendorja e LNÇ-së.

Kategoritë	Trashëgimia arkitektuale	Trashëgimia arkeologjike	Peizazhet kulturore
Numri	37	23	3
Sipërfaqja (ha)	13.62	134.63	/

**Tabela 1. Trashëgimia Kulturore në Komunë të Gjilanit**

Kategoritë	Monumente arkitektuale	Tërësi arkitektuale	Hapësira arkitektuale konservuese
Sipërfaqja (ha)	9.83	3.79	/

**Tabela 2. Trashëgimia arkitektuale në Komunë të Gjilanit**



Lokacioni/ Monumenti	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Gjilan / Atik Xhamia	X	0.20
Gjilan / Shtëpia e Isak Pozharanit	X	0.04
Gjilan / Çezma e Sahit Agës	X	0.19
Gjilan / Shkolla e muzikës ( Ish saraji I Mustafë Pashës)	X	0.10
Gjilan / Shtëpia e Zekirja Abdullahut	X	0.05
Gjilan / Objekti i Kajmekamllakut	X	0.14
Gjilan / Objekti i ish depos ushtarake turke	X	0.45
Gjilan / Objekti i Teknikës Popullore	X	0.02
Gjilan / Shtëpia e Farush Okllapit	X	0.02
Cërnicë / Oda e Fevzi Hoxhës	X	0.17
Cërnicë / Minarja e Xhamisë së Cërnicës	X	0.16
Kuvçë e Poshtme / Shtëpia Kullë e Sahit Agës	X	0.72
Zhegoc / Hani i Shefkiut	X	0.05
Zhegoc / Xhamia e Vërbicës së Zhegocit	X	0.07
Vërbicë Zhegoc / Shtëpia dhe Oda e Tefik Vehbi Zymberit	X	0.07
Kurexhaj / Kulla e Fetah Kurexhaj	X	0.11
Haxhaj / Kulla e Kadri Vebi Zeqirit	X	0.13
Dunav / Xhamia në Dunav	X	0.24
Dunav / Kisha e Shën Anës në Dunav	X	0.53
Sllakovc i Epërm / Mesxhidi në Sllakovc të Epërm	X	4.19
Velekincë / Xhamia e Vjetër në fshatin Velekincë	X	0.12
Pogragjë / Xhamia e Fshatit të Pogragjës	X	0.11
Pidiq / Xhamia në Fshatin Pidiq	X	0.1
Muçibabë / Xhamia në Fshatin Muçibabë	X	0.41
Llovcë / Xhamia në Fshatin Llovcë	X	0.15
Sllubicë / Xhamia në Fshatin Sllubicë	X	0.09
Bresalc / Ndërtesa ku është mbajtur Flaka e Janarit	X	0.05
Llashticë / Hambari i Feriz Llashticës	X	0.06
Burincë / Shtëpia e Haxhi Bekteshit	X	0.13
Kokaj / Shtëpia e Ajet Kokës	X	0.06
Kokaj / Shtëpi Banimi në Kokaj ( Ilmi Rrustemi)	X	0.1
Përlepticë / Shtëpi Banimi në Përlepticë ( Muhamer Shabani)	X	0.8
Shtëpia e Hajrullah Hajrullahut - Goden	X	0.9

Tabela 3. Monumentet arkitekturale në Komunë të Gjilanit

Lokacioni/ Tërësia arkitekturale	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Burnicë / Kompleks Arkitektonik, Lagja e Zmokëve	X	3.16
Tërziaj / Lagja e Hajdinëve, Kulla e Hajdin Hajdinit, Kulla e Xhelë Hajdinit	X	0.4
Selishtë / (Lagja e Malokëve, Ukë, Shaban, Rrahim Maloku)	X	0.23

Tabela 4. Tërësi arkitekturale në Komunë të Gjilanit

Monumente arkeologjike	Vendbanim arkeologjik	Strukture e ndërtuar nga dora e njeriut	Rezervat arkeologjik
11.31	132.32	/	/


Tabela 3 Trashëgimia arkeologjike në Komunë të Gjilanit

Lokacioni/ Monument arkeologjik	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Themelet e Kishës së Çartme në Pogragjë	X	0.78
Gërmadhat e Kishës së Shën Varvarës	X	0.16
Nekropoli tumular në Llashticë	X	1.04
Gjurmët e Kishës së vjetër në Llashticë	X	0.69
Kalaja e Resulës në Pidiq	X	0.45
Kalaja e Pidiqit - Shurdhanit	X	0.32
Kalaja e Mireshit	X	2.58
Kalaja e Përlepticës	X	2.44
Kalaja vrojtuese në Zhegoc	X	/
Gjurmët e Kishës së vjetër në Zhegoc	X	/
Gjurmët e Kishës së vjetër në Bresalc	X	27.76
Gjurmët e Kishës së vjetër në Vërbicë të Kmetocit	X	4.68
Gjurmët e Kishës në Kishnapolë	X	/
Fortifikata parahistorike në Cërnice	X	0.38
Kalaja e Bresalcit	X	/

Tabela 5. Monumentet arkeologjike në Komunë të Gjilanit

Lokacioni/ Vendbanim arkeologjik	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Kalaja në Pogragjë	X	120.00
Lokalitet romake në Kmetoc	X	0.32
Lokaliteti arkeologjik "Koka e Ilisë"	X	/
Vendbanimi periudhës romake në Cërnice	X	/
Vendbanimi I Nasalës	X	/
Vendbanimi Gllama, Bresalc	X	/
Vendbanimi Roanke	X	/

Tabela 6 Vendbanimet arkeologjike në Komunë të Gjilanit



### Asetet e Trashëgimisë Natyrore

Mbrojtja e objekteve dhe zonave të trashëgimisë natyrore është në kompetencë të MEA-së. Korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë është siguruar me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Sikurse trashëgimia kulturore ashtu edhe trashëgimia natyrore është një e mirë e përgjithshme, për tu shfrytëzuar dhe ruajtur nga të gjithë, të trashëgohet nga ne dhe gjenerata e ardhshme.

Momentalisht vlerat e trashëguara natyrore janë të rrezikuara, pasi që pas luftës zonat e mëdha kishin qenë subjekte të zhvillimit të pakontrolluar. Me hapësirë relativisht të vogël, Gjilani është i pasur me llojet e bimëve dhe drunjve. Ky është rezultat i bashkëveprimeve komplekse të faktorëve fizik duke krijuar llojllojshmërinë e gjerë të kushteve të vendbanimit për rritjen e bimëve. Uji ( liqenet, lumenjtë, përrojet , rrjedhat tjera ujore dhe burimet termale minerale) , është burimi kryesor natyror dhe në të njëjtën kohë element strukturorë në mjedis. Aktualisht në Gjilan janë 14 zona të propozuara për mbrojtje në listën e zonave të mbrojtura të Kosovës. Më poshtë janë listuar asete të trashëgimisë natyrore nën mbrojtje.

Lokacioni	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Shpella dhe Guri i Shtrigës, Resulë, Pidiq	X	/
Gryka e Llapushnicës, Pogragjë	X	6.00
Shpella e Bresalcit	X	/

*Tabela 1. 4 Asetet e trashëgimisë natyrore nën mbrojtje*


Lokacioni	Lloji
Lugina e Lumit Llapushnicë	Park natyror
Burimet Hidrotermale - Kmetoc	Monument natyror
Liqeni i Përlepticës me rrethinë	Peizazh i mbrojtur
Trungjet e dardhës së egër - Lipovicë	Monument natyror
Trungjet e bungut - Burincë	Monument natyror
Burimi i ujit termal – Uglar	Monument natyror
Burimi i ujit termal - Gumnishtë	Monument natyror
Trungjet e bungut - Ponesh	Monument natyror
Burimi i ujit mineral - Ponesh	Monument natyror
Trungjet e bungut - Parallovë	Monument natyror
Burimi i ujit termomineral - Pidiq	Monument natyror


*Tabela 2. Asetet e trashëgimisë natyrore*

Kjo pjesë do të mund të zhvillohet në një park të gjelbër rekreativ. Sheshi i afërt do të mbyllet dhe të integrohet në parkun e gjelbër rekreativ të peizazhit. Kjo pjesë duhet të zhvillohet në park të gjelbër rekreativ. Gurorja duhet të mbyllet dhe të integrohet në park. Përkundër elementeve të peizazhit të hapur kujdes i veçantë duhet ti kushtohet grykës së lumit Llapushnicës afër Pogragjës. Duhet të definohen mbrojtje e veçantë për zonat e caktuara.

### Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore

Në kuadër të trashëgimisë natyrore, në territorin e Komunës së Gjilanit përkatësisht në mes të fshatit Uglarë dhe Pogradjë gjendet hapësira prej 361 hektarësh e cila me vendimin 01. Nr. 5471 të Kuvendit të Komunës me datën 05.06.2008, është e shpallur “Zonë turistike me interes të veçantë”.





Pjesa tjetër e trashëgimisë natyrore që gjendet në territorin e komunës është e pa mbrojtur me ligj apo me vendime të komunës e që si e tillë ka vlera për tu trajtuar. Kjo trashëgimi i përket në radhë të parë vendburimeve me ujëra termale: Banja e Dobërqanit, Banja e Uglarit; burimet e ujërave termale në fshatin Gumnishtë, burimi i ujit termal në fshatin Përlepnicë, lokacioni Banja në Gjilan. Masivi guror “Guri i shpumë” në Përlepnicë, Shpellë mermeri në fshatin Bresalc, masivi pyjorë në Grykën e Karadakut, masivi pyjorë në Malet e Zhegovcit.



## Biogeografia dhe biodiversiteti

Biodiversiteti i Gjilanit është i shumëllojshme, në gjitha mjediset ujore, tokësore malore, urbane etj. Kjo llojllojshmëri është rezultat i kushteve jetësore që ekzistojnë në natyrë, është kushtëzuar nga relievi, përbërja gjeologjike dhe pedologjike e tokës, nga klima, nga hidrografia dhe nga ndryshimi i vazhdueshëm që është bërë si në të kaluarën ashtu edhe sot<sup>7</sup>.

### Zoodiversiteti:

Ka prejardhje të ndryshme, është i pasur dhe mjaft i dobishme për njeriun dhe ekonominë. Në pyjet e gjëra të ahut, në zonën e Karadakut jetojnë: ujku, dhelpra, qelbësi, ariu i murrmë, kunadhja e pishës, macja e egër, rrëqebulli, vjedulla, kaprolli, dhia e egër dhe derri i egër. Rajoni i Gjilanit ka shumë lloje lakuriqësh dhe shumë lloje shpendësh. Në kuadër të shpendëve dallohen: mishngrënësit si shqiponja e maleve dhe disa lloje të fajkonjve të cilët ndodhen në fushat rreth lumit Morava, nga shtegtaret (lejleku, dallëndyshja). Herpetofaunën e përbëjnë shumë zvarranikë, si: hardhucat, gjarpërinjtë, gjarpërinjtë e ujit, bolla, nepërka helmuese, dhe amfibia (ujëtokësore), si dhe bretkosa.

Në ujëra jetojnë disa lloje peshqish, ndër ta më e njohura është trofta, e cila në lumenjtë në rrjedhat e poshtme më nuk ekziston.

### Fitodiversiteti

Rajoni i Gjilanit ka florë të pasur, me lloje të ndryshme bimësh: të ulëta dhe të larta. Bimët e ulëta. Në këtë rajon janë të përfaqësuara nga algat e ndryshme, kërpudhat dhe likenet. Algat hasen në lumenj, liqene, vende me lagështi, pastaj pranë lumenjve, si në gurë e në lëvore të drunjtëve. Mjaft e përhapur është: alga gjelbër-kladofora (Cladophora), Oedogoniumi, Muzhocia (Mougeotia), Zygnema, Spirogira, alga e kaltër në të gjelbër (Cyanophyta), Oscillatoria (Oscillatoria), Klamidomonasi me shumëzim masiv, në pranverë bënë që sipërfaqja ujore të marrë ngjyrën e gjelbër në liqenin e Livoqit dhe të Përlepticës. Si alga të tjera, më të përhapurat janë edhe Euglena e Ulotriksi. Kur zhvillohen shumë, sidomos gjatë verës, në ujëra të ndenjura, si liqenin e Livoqit dhe të Përlepticës, basene shkaktajnë —lulëzim ujorl. Në kuadër të algave të tipit Cyanophyta, ka lloje toksike, siç janë ato të gjinisë mikrocistis, anabaena, etj.

Kërpudhat në komunën e Gjilanit janë të përhapura, si: ushqyese, helmuese dhe parazitë, gati në gjitha mjediset, Kërpudhat ushqyese - më të përhapura janë ato kapelore, si të fushës dhe të pyjeve, si: agarikusi, likoperdoni, pelatumi, laktariusi, delecusi, boletusi, edulisi etj. Mjaft e përhapur është kërpudha eshkë (Fomes fomentarius), e cila rritet e përforcuar për trugje të bimëve të larta.

<sup>7</sup> Shënimet nga drefti i Plani Zhvillimor Komunal i Gjilanit 2023 – 2031

Kërpudhat helmuese- karakterizohen me ngjyra të bukura dhe tërheqëse, si: amanita, muskaria, boletus santanas etj.

Kërpudhat parazitë të drithërave- shkaktojnë dëme të mëdha drithërave, dhe përfaqësohen nga gjinitë Ustilago (Uthi, urthi) si: Ustilago tritici, paraziti në kallirin e grurit, Ustilago zea, në kallirin (tramakun) e misrit, Ustilago avena, në kallirin e tërshërës, Ustilago hordhi, në kallirin e elbit; pastaj përfaqësuesit e gjinisë Uredinales (ndryshku), Puccinia graminis (ndryshku), parazit në kallirin dhe kërcellin e grurit. Në kumbull paraziton kërpudha Taphrina pruni, në pjeshkë Taphrina deformans, në qershi Taphrina cerasi. Ndërkaq kërpudha parazit, Plasmopora viticola, infekton gjethet dhe frutat.

Kërpudhat e mykut janë mjaft të përhapura, si myku i bukës, Mucor mucedo që jeton si saprofit, pra, ushqehet me materie organike jo të gjalla, si buka, plehra etj.

Kërpudhat medicinale - Shumë kërpudha janë të përhapura në rajon dhe përdoren për qëllime medicinale, p.sh. Lactarius rifus dhe Lactarius deliciosus.

Likenet në komunën e Gjilanit - më të përhapura janë: ksantoria (xanthoria), usnea barbata, evernia, dhe ramelina. Bimët e larta (Cormophyta) - Prej bimëve të larta janë të përhapura myshqet, fieri, bimët farëveshura si dhe ato farëzhveshura.

Prej myshqeve (Bryophyta) janë të njohura Polytrichum commune dhe Marchantia polymorpha. Fiernat më të përhapur në rajon janë: Këputja e arave (Equisetum arvense), Gjuhëgjarpër (Ophioglossum vulgatum). Njihen gjithashtu edhe fiernat e familjes Polypodiace, p.sh. Fieri shqiponjë (Pteridium aquilinum), Fieri i pyllit (Dryopteris filix-mas) që përdoret në mjekësi kundër parazitëve të zorrëve.

Farëzhveshura, më të njohura janë: pisha e bardhë, pisha e zezë, dëllinja dhe harmoçi. Bimët farëveshura drunore Bimët farëveshura drunore më të njohura janë: Shelgu (Salix), plepi (Populus), frashri (Fraxinus), shkoza, bliri (Tilia), ahu (Fagus sylvaticus), bungu (Quercus robur), qarri (Quercus cerris), panja (Acer heldreichii), vidhi (Ulnus campestris), pisha (Pinus). Bimët farëveshura drunore me fruta si: molla, dardha, qershia, pjeshka, kumbulla, arra, gështenja, kajsia, rrushi, janë mjaft të përhapura në rajonin e Gjilanit.

Bimët farëveshura barishtore (drithërat) si gruri (Triticum vulgare), misri (Zea mays), tërshëra (Avena sativa) dhe elbi (Hordeum sativum), kanë rëndësi të veçantë për banorët e këtij rajoni.

Bimët farëveshura barishtore frutore si: shalqiri (bostani), pjepri, kungulli, domatja, patëllxhani, speci, karota, majdanozi, panxharsheqeri, luledielli, janë mjaft të përhapura në rajonin e Gjilanit.





## ZONAT E PRODHIMTARISË BUJQËSORE

Komuna e Gjilanit, me një relief mjaft heterogjen dhe me një klimë të mesme kontinentale, ofron kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht të degëve të saj: lavërtarisë dhe blegtorisë. Vlerësohet se në etapa të ndryshme, më se 60% e popullsisë së Gjilanit me rrethinë është marrë me bujqësi.

Komuna e Gjilanit, me një sipërfaqe prej 392 km<sup>2</sup>, shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës dhe vlerësohet se ka:

- rreth 14,200 ha, tokë të punueshme,
- mbi 20,000 ha pyje dhe kullosa, dhe
- 13,550 ha tokë djerrinë.

Para lufte bujqësia ka qenë bazë e mirë për sigurimin e jetës në zonat rurale dhe ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e infrastrukturës së fshatit dhe në avancimin e të gjitha sferave të jetës, përfshirë arsimimin, kulturën, sportin etj.

Toka bujqësore sipas pronësisë:

Pronë private (ha)	Pronë komunale (ha)	AKPM (ha)	Të tjera (ha)	Gjithsej (ha)
24198.6	1793.969	2349.862	10822.57	39165

Burimi: Kuvendi i komunës

### Prodhimtaria bujqësore<sup>8</sup>

Bazuar në zhvillimet bujqësore të katër viteve paraprake janë identifikuar trendët prodhuese, në bazë të analizave sektori i perime/kulturës ka një rritje me një përqindje prej 9.39%, që vlerësohet si rritje është reale. Ndërsa, prodhimtaria pemëtore në bazë të dhënave të grumbulluara dhe më pastaj të analizuara vërehet një rrënjë e prodhimit ku mesatarja e kësaj rrënje është -11.25% , nga trendët të cilat janë paraqitur në tabelë jep të kuptohet se sektori i prodhimit të pemëve nuk është në gjendjen më të mirë prandaj si institucione duhet të merren masa në përmirësimin sa me të shpejt të këtij sektori mjaft të rëndësishëm në të ushqyerit e njerëzve si dhe zhvillimit ekonomik.

<sup>8</sup> Shënime: Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari - Gjilan

		Spec	Domate	Tranguj	Molla	Dardha	Kumbull	Vishnje	Arra
Prodhimi (t/ha)	2015	10.00	20.00	22.00	25.00	8.00	30.00	10.00	4.00
	2016	10.00	25.00	25.00	25.00	7.00	30.00	8.00	4.00
	2017	12.00	26.00	26.00	20.00	7.00	30.00	7.00	3.00
Trendët e prodhimit (%)	2015-2016	0.00	20.00	12.00	0.00	-14.29	0.00	-25.00	0.00
	2016-2017	16.67	3.85	3.85	-25.00	0.00	0.00	-14.29	-33.33
	2015-2017	16.67	23.08	3.85	-25.00	0.00	0.00	-14.29	-33.33
(MS) Rritjes Vjetore (%)		8.33	11.92	7.92	-12.50	-7.14	0.00	-19.64	-17

*Trendët e prodhimit të bujqësore*

Bazuar në zhvillimet bujqësore të katër viteve paraprake janë identifikuar projeksionet vijuese të prodhimit të bujqësore për 8 vitet:

	Spec	Domate	Tranguj	Molla	Dardha	Kumbull	Vishnje	Arra
2019 - 2020	10.67	23.70	24.33	23.33	7.33	21.00	8.33	3.67
2021 - 2022	11.56	26.53	26.26	20.41	6.81	21.00	6.69	3.06
2023 - 2024	12.52	29.69	28.34	17.86	6.32	21.00	5.38	2.55
2025 - 2026	13.56	33.23	30.58	15.63	5.87	21.00	4.32	2.12
2027 - 2028	14.69	37.19	33.00	13.68	5.45	21.00	3.47	1.76

*Projeksionet dyvjeçare të prodhimit të bujqësore për 8 vitet e ardhme*

Bazuar në zhvillimet bujqësore të viteve paraprake mund të vërehet që prodhimi i drithërave si dhe ushqimit voluminoz ka një trend të rritjes së vazhdueshme ndër vite. Prodhimi i drithërave ka një rritje mesatare prej 2.81 % së rritjes së përgjithshme të prodhimit të drithërave. Ndërsa, ushqimet voluminoze si jonxha dhe bari kanë një mesatare të rritjes prej 6.20%.

Bazuar në zhvillimet bujqësore të katër viteve paraprake janë identifikuar prognozatat vijuese të prodhimit të bujqësore për 8 vitet e ardhme:

	Grurë	Misër	Elbi	Tërshërë	Jonxhë	Bari
2019 - 2020	4.60	2.63	4.27	2.13	9.27	4.27
2021 - 2022	4.95	2.67	4.56	2.16	9.65	4.63
2023 - 2024	5.33	2.71	4.87	2.19	10.04	5.01
2025 - 2026	5.74	2.75	5.20	2.21	10.45	5.43
2027 - 2028	6.18	2.79	5.55	2.24	10.88	5.88

*Prognozatat dyvjeçare të prodhimit të bujqësore*

		Grurë	Misër	Elb	Tërshërë	Jonxhë	Bari
Prodhimi (t/ha)	2015	4.40	2.50	3.90	2.20	9.00	4.00
	2016	4.10	2.80	4.40	1.70	9.00	4.00
	2017	5.30	2.60	4.50	2.50	9.80	4.80
Trendët e prodhimit (%)	2015-2016	-7.32	10.71	11.36	-29.41	0.00	0.00
	2016-2017	22.64	-7.69	2.22	32.00	8.16	16.67
	2015-2017	16.98	3.85	13.33	12.00	8.16	16.67
(MS) Rritjes Vjetore (%)		7.66	1.51	6.79	1.29	4.08	8.33

Tab

Trendët e prodhimitarisë bujqësore


### Sipërfaqet pyjore:

Komuna e Gjilanit, me një relief mjaft heterogjen dhe me një klimë të mesme kontinentale, ofron kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht degëve të saja: lavërtarisë dhe blegtorisë. Vlerësohet se në etapa të ndryshme më se 60% e popullsisë së Gjilanit me rrethinë është marrë me bujqësi dhe jo rastësisht Gjilani njihet si qytet agro-industrial.

Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 391 km<sup>2</sup>, sa ka Komuna e Gjilanit, vlerësohet se tokë bujqësore dhe pyje janë rreth 40.000 Ha. dhe nga kjo:


- 8.000 Ha. pyje publike;
- 12.000 Ha. pyje private;
- 13.500 Ha. ara të punueshme;
- 7.000 Ha, livadhe dhe kullosa.

Spektori privat Ha.	Spektori shoqëror Ha.	Gjithsej Ha.
12.000	8	20.000



26/07/2023 2:11 PM  
© MSc. Gjeografisë Amir REXHA

## Sipërfaqet Pyjore Komuna e Gjilanit



## Zonat industriale dhe objektet ekonomike

Kompanitë prodhuese, ndërtimore dhe publike në komunën e Gjilanit				
	Kompania	Lokacioni	Menaxhmenti	Nr. punëtorëve
1	Dea Compact Group	Fshati Gumnishtë	Fadil Shala	47
2	Fluidi-Floil	Fshati Velekincë	Berat Mustafa	136
3	Flexograf	Fshati Velekincë	Bujar Mustafa	70
4	RC-COLA	Fshati Velekincë	Fejzullah Mustafa	150
5	Tali Shpk	Gjilan-Parallovë	Florim Zuka	25
6	Bejta Comerc	Gjilan	Adem Kqiku	38
7	Krm Higjiena	Gjilan	Senad Ramaj	141
8	Kompania "Hidromorava"	Gjilan	Ymer Salihu	91
9	Posta Telekomit	Gjilan	Musa Sermaxhaj	163
10	KEDS	Gjilan	Ramdan Ameti	220
11	Agmia Center	Gjilan	Ahmet Demiri	50
12	Viva Fresh Store	Gjilan	Xhevdet Rexhepi	33
13	ETC	Gjilan	Ramiz Kelmendi	98
14	Interex	Gjilan	Valon Lluka	62
15	Integj	Gjilan	Ibrahim Krivaqa	19
16	Fabrika e Radiatorëve(ENRAD)	Gjilan	Fatmir Rexhepi	172
17	Forma	Fshati Bresalc	Besim Rexhi	64
18	Euromodel	Gjilan	Rufat Dushica	40
19	Palma	Gjilan	Ekrem Shahini	135
20	Moea	Fshati Kravaricë	Armend Malazogu	10

Depot ushqimore					
	Emri i subjektit	Adresa	Lokacioni	Pronari	Telefoni
1	Diti Com	Xhorxh Washington,	Gjilan	Flamur Korça	044 127 749
2	Ballkania	17, Dardania I	Gjilan	Naser Mehmeti	044 125 619
3	Rita	GRR.Idriz Seferi	Gjilan	Zijadin Selimi	044 477 447
4	Uka	Rr.Medllin Ollbrajt	Gjilan	Isuf Uka	044-132-557

<b>Industria e përpunimit të mishit dhe qumshtit</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Lloji i veprimtarisë së mishtores</b>	<b>Përfaqësimi</b>	<b>Lokaliteti</b>
1	Mishtore Rama	Përpunimi i mishit	Fatbardh Mehmeti	Gjilan
2	Mishtore Gazi	Përpunimi i mishit	Valdrin Mehmeti	Gjilan
3	Mishtore Arisi	Përpunimi i mishit	Xhevdet Selimi	Gjilan
4	Mishtore Engjulli	Përpunimi i mishit	Ferinaze Pajaziti	Gjilan
7	N.T.P. "MISHTORE PAJAZITI"	Përpunimi i mishit	Bahri Pajaziti	Gjilan
8	Driton Sermaxhaj B.I.	Përpunimi i mishit	Driton Sermaxhaj	Gjilan
9	Burim H. Qerimi B.I.	Përpunimi i mishit	Burim Qerimi	Gjilan
11	N.SH.T. "GINI COM "	Përpunimi i mishit	Bexhet Mehmeti	Gjilan
13	EXTRA - AS SH.P.K.	Përpunimi i mishit	Kurtesh Kurteshi	Livoq i Epërm
14	Eco - Products SH.P.K.	Përpunimi i mishit	Enver Sahiti	Gjilan
15	N.T.P. "Labinoti"	Përpunimi i mishit	Fatmir Syli	Gjilan
16	N.T.P. "Labi-Commerce"	Përpunimi mishit	Rabit Pajaziti	Gjilan
17	MALËSIA SH.P.K.	Përpunimi i mishit	Nehat Spahiu	Gjilan
18	CALABRIA SH.P.K.	Përpunimi i mishit	Bajar Selimi	Velekincë
19	Gazi Com	Thertore		Gjilan
20	Konsoni	Thertore		Gjilan
21	Malësia	Thertore		Gjilan
22	Kalabria	Thertore		Gjilan
23	Kabi	Qumshstore		Kmetoc

### **Asetet Turistike**

Komuna e Gjilanit ka potenciale të mira për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit, investimet e bëra kohëve të fundit nga sektori privat në turizëm ofertën turistike të Gjilanit e bëjnë atraktive për klientelën turistike vendore e ndërkombëtare. Malet e Zhegocit, Malet e Kardakut, janë aset në vete për këtë komune ku mund të zhvillohet turizmi rural e njëkohësisht edhe turizmi i kalërimit, çiklizmit e motoçiklizmit, ecjes në natyrë etj.

Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit të turizmit si Kalaja e Pogragjës, gjendet në kilometrin e 10 nga qyteti i Gjilanit, në fshatin Pogragjë, krahas kalasë është mjaft atraktive edhe Gryka e Llapushnicës. Atik Xhamia, Xhamia e Cernicës, Xhamia e Dobërqanit, Kisha katolike „Kisha e Shën Anës” në fshatin Dunav, Tyrbet në qytet, Kisha e Shën Nikollës, Sahat Kulla. Pastaj janë Atraksionet Natyrore: Liqeni e Livoqit, Lokaliteti Stublinë, Lokaliteti Zhegoc me rrethinë , burimet termale në Uglar dhe Dobërqan.



## Objektet e banimit

Zona urbane e qytetit të Gjilanit karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 230 banorë/m<sup>2</sup>. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane, ku shtrihen kryesisht njësi të banimit. Sa përket numrit të strukturave të ndërtuara, në nivel komune numri më i madh i ndërtesave i përkasin shtëpive të banimit më 46%, pasuar me banim me shumë njësi 13%. Viteve të fundit, për shkak të presionit për zhvillim ka kërkesë më të madhe për objekteve të banimit me shumë njësi.

Pas një analizë të ndërtesave të banim të zbrazëta, përfshirë dhe mundësitë për ri-përdorimin e tyre, janë identifikuar ndërtesat që potencialisht mund të ri-përdoren si dhe është konstatuar se shumica e banesave të cilat konsiderohen të zbrazëta në komunën e Gjilanit, nga regjistrimi i vitit 2011, në fakt janë pronë dhe shfrytëzohet nga banorët që konsiderohen jo rezident.

14	Dobërçan 1	7548023.559; 4704854.890; 437.00	1.64	Pus nëntokësor
15	Dobërçan 2	7548037.699; 4704849.150; 437.00	1.5	Pus nëntokësor
16	Dobërçan 3	7548090.339; 4704808.550; 437.00	1.5	Pus nëntokësor
17	Llovce	7546600.044; 4696175.165; 699.00	0.22	Pus nëntokësor
18	Zhegër		3.01	Pus nëntokësor
Totali:			353.92	

Tabela 10 Burimet kryesore të furnizimit me ujë dhe kapacitetit i burimeve/Ref KRU Hidromorava

<sup>10</sup> Të dhënat: KRU Hidromorava

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme dhe raportet e KRU Hidromorava, kapacitetet e burimeve ujore për Gjilanin me të cilat menaxhon KRU Hidromorava arrin prurjen prej  $Q=353.92$  l/s.

Burimet e ujit	Kapaciteti i prodh. maks.	Kapaciteti i shfrytëzuar (prodhimi)			
	(m <sup>3</sup> /vit)	(m <sup>3</sup> /vit)	(m <sup>3</sup> /ditë)	(m <sup>3</sup> /orë)	(l/sek)
FPU Përlepnice dhe Guri i Hoxhës	7,300,000.00	6,324,480.00	17,331.14	722.13	200.59
FPU Velekincë	2,100,000.00	2,023,834.00	5,545.97	231.08	64.19
Baja	650,000.00	632,448.00	1,733.11	72.21	20.06
Malisheva e Ulët	95,000.00	94,867.00	259.97	10.83	3.01
Malisheva e Epërme	35,000.00	31,622.00	86.65	3.61	1
Dobërçan	95,000.00	94,867.00	259.97	10.83	3.01
Llovcë	32,000.00	31,622.00	86.65	3.61	1
Zhegër	260,000.00	252,979.00	693.25	28.89	8.02
Prodhimi total:	10,567,000.00	9,486,719.00	25,996.71	1,083.20	300.89

Tabela 34 Burimet e ujit dhe kapacitetet e shfrytëzimit në komunën e Gjilanit/Ref KRU Hidromorava

Kapacitetet të prodhimit të ujit (kapacitetet e shfrytëzuara) me të cilat furnizohet e tërë zona e shërbimit në komunën e Gjilanit janë  $Q=300.89$  l/s

### Rezervuarët e ujit

Sipas gjendjes ekzistuese të përshkruara në raportet sektoriale për infrastrukturën teknike të ujësjellësit dhe në raportet e KRU Hidromorava, kapacitetet e rezervuarve të ujit për furnizimi me ujë të pijshëm për qytetin e Gjilanin dhe fshatrat përreth me të cilat menaxhon KRU Hidromorava arrin vëllimin prej  $V=7265\text{m}^3$  ujë. Rezervuarët e ujit furnizojnë qytetin e Gjilanit dhe 9 fshatra (vendbanime rurale) dhe janë paraqitur në tabelën e mëposhtme ku në përmbajtje përbëjnë: emrin e rezervuarit, koordinatat (matjet gjeodezike), vëllimi, lloji i rezervuarit dhe sipërfaqja e rezervuarit në (ha).

Rezervuarët distributive të ujit të trajtuar					
Nr	Emri i rezervuarit	Koordinatat (X,Y,Z)	Vëllimi i rezervuarit (m <sup>3</sup> )	Lloji i Rezervuarit	Sip e rez. (Ha)
1	Kodra e dëshmoreve	7537731.3296, 4702139.4227, 477.13	3000	Rez. Nëntokësor	0.21
2	Velekincë	7538951.8385, 4698064.0305, 497.00	1000	Rez. Nëntokësor	0.11
3	Përlepnice	7542561.2423, 4709229.2595, 605.00	1050	Rez. Nëntokësor	0.34
4	Baja	7537851.5122, 4703764.5737, 518.00	350	Rez. Nëntokësor	0.1
5	Pasjan	7538951.8385, 4698064.0305, 497.00	350	Rez. Nëntokësor	
6	Zhegër	7540219.9643, 4693223.4463, 574.00	500	Rez. Nëntokësor	0.06
7	Malishevë 1	7543221.8805, 4701715.6510, 634.00	100	Rez. Nëntokësor	0.016
8	Malishevë 2	7543341.900; 4701368.750; 596.00	350	Rez. Nëntokësor	0.013
9	Te Fermat	7539717.3149, 4700627.7307, 567.00	115	Rez. Nëntokësor	0.29
10	Llovcë	7546935.044; 4696808.805; 672.00	100	Rez. Nëntokësor	0.024
11	Dobërçan	7547005.120; 4704691.480; 541.00	350	Rez. Nëntokësor	0.029
<b>Totali:</b>			<b>7265</b>	<b>Totali:</b>	<b>1.192</b>

Tabela 11 Kapaciteti i rezervuarëve/Ref KRU Hidromorava

### Stacionet e Pompimit

Kapacitetet e Stacioneve të Pompimit të ujit po ashtu shërbejnë për shtytjen dhe furnizimin me ujë për pije qytetin dhe 8 fshatra (vendbanime rurale), me stacionet e instaluar gjithashtu menaxhon KRU Hidromorava dhe kapaciteti i tyre është paraqitur në tabelën e më poshtme ku në përmbajtje përbën: emrin e stacionit të pompimit, koordinatat (x,y,z)(matjet gjeodezike), fuqinë instaluese dhe numrin e pompave të instaluara.

	Emri i stacionit të pompimit	Koordinatat (X,Y,Z)	(kW)Fuqia Instaluese	Nr. i pompave
1	St. Pompë Velekincë	7538946.099; 4698060.550; 497	75	3
2	St. Pompë kryesor Përlepticë	7542563.459; 4709224.490; 603	75	4
3	St. Pompë Baja	7537884.164; 4703697.405; 518	41	4
4	St. Pompë Pasjan	7538946.584; 4698052.825; 497	7.5	2
5	St. Pompë Zhegër	7538946.584; 4698052.825; 497	14	2
6	St. Pompë Malishevë	7543221.584; 4701715.651; 621	4.5	2
7	St. Dobërçan	7548023.650; 4704856.060; 437	2.5	2
8	St. Llovcë	7546618.500; 4696160.600; 543	11	1


Tabela 12 Kapaciteti i pompave/Ref KRU Hidromorava

### Rrjeti i Ujësjesit

Rrjeta e ujësjesit është e ndërtuar sipas kapaciteteve të burimeve dhe rrjeta kryesore e ujësjesit (Gypi Primar) është e ndërtuar nga liqeni i Përlepticës deri në qytetin e Gjilanit dhe i cili ka një diametër Ø400mm me gjatësi afërsisht 7 km dhe përbëhet nga materiali Azbest Cement (AC).

Deri me tani në rrjetin primar dhe sekondar të ujësjesit janë ndërtuar rreth L= 344.728 km gypa të ujit të cilat variojnë nga diametri Ø50mm deri Ø400mm, ndërsa në rrjetin terciar (kycjet shtëpiake dhe ekonomive tjera) janë realizuar L=268.274 km, Gypat e Asbest Cement (AC) të cilat janë të instaluar vite më parë, ende nuk janë zëvendësuar me materiale të standardizuara dhe arrijnë gjatësinë prej L=37.830 km ose 10.97% e rrjetit të përgjithshëm, si dhe 21.11 km PVC ose 6.12 %. Pjesa më e madhe prej gjatësisë L= 344.728 km e rrjetit primar dhe sekondar të komunës së Gjilanit është nga materiali HDPE PE 100.

Po ashtu në nivel Regjional gjatësia e gypave të mbetur me Azbest Cement (AC) është rreth L=49.565 km gypa ose 21.1% e rrjetit të përgjithshëm. Pasqyrën e përqindjes së gypave sipas materialeve të instaluar në ujësjesin e Gjilanit dhe 9 fshatrave përreth është treguar në grafikën e më poshtme:




Grafiku 1 Gypat e instaluar sipas materialit në rrjetin e ujësjesit në Gjilan (Qyteti)/Referenca KRU Hidromorava

Uji nga liqeni së pari transportohet deri te fabrika për përpunim (FPU ) dhe përmes procesit teknologjik bëhet trajtimi deri në trajtimin për ujë të pijes dhe pastaj uji dërgohet përmes gypit transportues për furnizim të banorëve të qytetit të Gjilanit dhe fshatrave përreth, po ashtu si përf forcime të jashtme për rritje të sasisë së ujit shfrytëzohen edhe burimet e Bajes dhe Velekincës. Rrjeti i ujësjellësit i ndërtuar deri në 2020 në zonën urbane dhe që Menaxhohen nga KRU Hidromorava (Sipas Numrit të banorëve %).

Nr Banorëve 2020	Nr i vendbanimeve	Përqindja (%) e kyçjes së banorëve në rrjet
48.104	1	95

Tabela 13 Mbulueshmëria me rrjet të ujësjellësit në qytet



Grafiku 2 Mbulueshmëria me rrjet të ujësjellësit në zonën urbane (qytet)

Rrjetet e ujësjellësit të ndërtuara deri në 2020 në zonat rurale dhe të menaxhuara nga KRU Hidromorava (Sipas Numrit të banorëve %)

Nr.	Vendbanimet Rurale me ujësjellës që menaxhohen nga KRU "Hidromorava" Sh.a.	Nr. Banorëve sipas 2020	% e kyçjes së banorëve në rrjet
1	Dobërçan	2.357	40%
2	Kmetoc	613	
3	Livoç i Ulët	3.101	
4	Llovcë	150	
5	Malishevë	2.807	
6	Përlepticë	1724	
7	Shillovë	485	
8	Velekincë	1.421	
9	Zhegër	2.943	
10	Nasala	185	
	Banorë të kyçur Të zonës Rurale	12.843	
	Gjithsej Banorë të zonës Rurale	31.888	

Tabela 14 Mbulueshmëria me rrjet të ujësjellësit-fshatrat që menaxhon KRUH

Emërtimi i vendbanimit në komunën e Gjilanit	Sistemet e ujësjellësit të menaxhuara nga KRU deri me 2019	Sistemet e reja të ujësjellësit që janë në ndërtim e sipër e që priten të shtohen KRU-s nas vitit 2020	Vendbanimet me sistem të ujësjellësit jo funksional	Vendbanimet që nuk kanë sistem të ujësjellësit	Nr. Banorëve sipas 2020	Nr.i Vendbanimeve	% e mbulueshmërisë me rrjet
Bilinicë		X			279	48	63%
Bresalc		X			2.503		
Bukovik				X	71		
Burincë					0		
Capar				X	185		
Cërnice			X		1.741		
Çelik				X	77		
Demiraj				X	108		
Dobërçan	X				2357		
Dunav				X	9		
Gadish				X	294		
Goden				X	26		
Gumnishtë				X	420		
Haxhaj				X	188		
Inatoc				X	27		
Kishnapolë				X	208		
Kmetoc	X				613		
Kravaricë				X	234		
Kurexh				X	349		
Lipovicë				X	21		
Livoç i Epërm		x			2.263		
Livoç i Ulët	X				3.102		
Lladovë			X		483		
Llashticë			X		1.441		
Llovçë	X				150		
Malishevë	X				2.807		
Muçibabë		X			71		
Nasalë	x				185		
Përlepticë	X				1.724		
Pidiq				X	303		
Pogragjë			X		1.074		
Ponesh		x			866		
Selishtë				X	158		
Sllakove i Epërm				X	227		
Sllakove i Ulët				X	57		
Sllubicë				x	65		
Stançiq				X	7		
Stublinë				X	70		

Shillovë	X				485	
Shurdhan				X	138	
Terzijaj					0	
Uglar				X	905	
Velekincë	X				1.421	
Vërbicë e Kmetocit		X			309	
Vërbicë e Zhegocit		X			518	
Vrapçiq		X			257	
Zhegër	X				2.943	
Zhegoc				X	149	

*Tabela 15 : Vendbanimet rurale (Fshatrat) me sistem të ujësjellësit (mbulushmeri) duke përfshirë edhe ato që cilat menaxhohen nga KRUH (Sipas Numrit të banorëve %)*

Në raportet e hartuara dhe përshkrimet e gjendjes aktuale, rrjetet e ujësjellësve të ndërtuara dhe në ndërtim e sipër në vendbanimet (zonat rurale) të Gjilanit arrin mbuleshmërinë (shtrirjen) e furnizimit me ujë të pijshëm rreth 63% .

Mbulueshmëria me rrjet në vendbanimet në ndërtim e sipër në zonat rurale si Verbicë e Kmetocit (me Nr të banorëve 309), Bilinicë (me Nr të banorëve 279), Muqibabë (me Nr të banorëve 71) Ponesh, (me Nr të banorëve 866), Vrapçiq (me Nr të banorëve 257), Bresalc (me Nr të banorëve 2503), Livoç i Eperm (me Nr të banorëve 2263), Verbicë e Zhegocit (me Nr të banorëve 518), ku në total shtohen edhe 7,066 banor.

Mbulueshmëria e përgjithshme e rrjetëve të ujësjellësit duke përfshirë zonen urbane, rurale dhe rrjetet në ndërtim arrin rreth 82% të numrit të përgjithshëm të banorëve në komunën e Gjilan

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të KRU "Hidromorava" është 21,990 konsumator, gjersa konsumi mujor është 241866.10m<sup>3</sup>.

	Klient të amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
<b>Numri i konsumatorëve</b>	19.947	117	1.929
<b>Shpenzimet sipas konsumatorëve (m<sup>3</sup>/muaj)</b>	207.789,48	13.312	207.64,62

*Tabela 16 Numri i konsumatorëve dhe konsumi mujor i klientëve të Hidromoravës''*

Numri i përgjithshëm i konsumit mujor në vitin 2018 është; 241,866.10 m<sup>3</sup>/muaj, të amvisërisë 207,789.48 m<sup>3</sup>/muaj, publik 13,312.0 m<sup>3</sup>/muaj dhe komercial 20,764.62 m<sup>3</sup>/muaj.





## EKO HIGJIENA

Eco-Higjiena SH.P.K<sup>11</sup>., me seli në Gjilan, është e themeluar më datën 23 maj 2012, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Partneritetit Publiko-Privat), ndërsa veprimtarinë e saj e ka filluar më datë 1 korrik të vitit 2012. Operimi i kësaj organizate shtrihet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti, ndërsa ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me Komunën Novo Bërd.

Eco-Higjiena Sh.P.K., bënë grumbullimin, bartjen dhe trajtimin e hedhurinave si dhe ofrimin e shërbimeve tjera publike siç është pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, parqeve, shesheve të qytetit, varrezave dhe tregjeve.

Aktivitetin e saj e ushtron në pajtim me dispozitat ligjore të aplikueshme të Republikës së Kosovës duke qenë e pajisur me Licencën përkatëse prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Eco-Higjiena SH.P.K., ka të punësuar **121** punëtorë, respektivisht **80 punëtor në Gjilan**, 16 punëtor në Viti, 18 punëtor në Kamenicë dhe 7 punëtor në Novobërdë.

Me aktivitetin e saj që ushtron, Eco-Higjiena SH.P.K., ndikon direkt në mbrojtjen e ambientit dhe hapësirës ekologjike dhe në mënyrë indirekte në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve.

Eco-Higjiena SH.P.K., është anëtare e Odës Ekonomike të Kosovës, anëtare e Shoqatës PAMKOS, e Organizatës OeKG – Shoqërisë Austro-Kosovare, anëtare në EIC (European Investors Council) dhe asociacione të tjera.

### Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Tabela në vijim e ndanë zonën e shërbimit në tre seksione: zona urbane qendra, zona peri urbane dhe zona rurale. Në qytet mënyra predominante e shërbimit është me kontejnerë të përbashkët ndërsa në zonën rurale forma e shërbimit është derë më derë. Frekuenca e shërbimit për zonën urbane është 1 – 2 herë në ditë varësisht nga sezon dhe gjenerimi i mbeturinave ndërsa në zonën rurale mbeturinat grumbullohen një herë në javë. Sa i përket infrastrukturës ndarëse ajo nuk ekziston në komunë dhe mbeturinat hedhen në kontejnerë/shporta në mënyrë të përzier dhe si të tilla grumbullohen nga operatori.

### Gjenerimi i mbeturinave;

Bazuar raportet e vjetore për vitin 2022, në komunën e Gjilanit, sasia totale e mbeturinave të grumbulluara është 25,379,95 ton, mbeturina komunale dhe janë ofruar shërbime për 85,590 banorë, rezulton se gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori në komunën e Gjilanit për vitin 2022 është 0,81 kg/banor/vit. Nga analiza të dhënave të raportuara është siguruar një bazë solide e të dhënave për të nxjerrë një rezultat të besueshëm të nivelit të gjenerimit të mbeturinave komunale gjatë vitit 2022.

<sup>11</sup> Të dhënat: Eco – Higjiena SH.P.K., Gjilan, 2023.

Njësia punuese Gjilan -stafi		
1	Krye puntorë	1
2	Shofer	12
3	Puntorë	23
	<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>

Stafi indirekt dhe administrativ		
4	Minaxhmenti i lartë	7
5	Zyrtar të rangut të mesëm	28
6	Staf teknik	2
7	Zyrtar të rangut fillestar	7
8	Staf tjetër	2
	Gjithsej	46
	<b>Toali i stafit</b>	<b>82</b>

Kamionë për grumbullim		
1	MAN TGA 26360 11.7 t	06-346-BT
2	MAN Variopres/Ledi 15.5 t	06-134-DK
3	IVECO MP 190 E 37 H 5.3 t	06-948-AH
4	IVECO MP 190 E 37 H 5.3 t	06-761-BS
5	Mitsubishi Fuso Center FE 4 t	06-716-BC
6	Mitsubishi Fuso Center FE 4 t	06-715-BC
7	Mitsubishi Fuso Center FE 4 t	06-837-BH
8	VË-Crafter 2 t	06-995-EO
9	Mercedes 12 t	06-641-EM
10	Mercedes 12 t	06-623-EN
11	Mercedes 12 t	06-672-EM
12	Mercedes 4 t	06-935 -FK
13	Mercedes	06-639-EM
14	Mercedes	06- 734-FK
15	Mercedes	06-416-FG



## Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës

	Emri i kompanisë (personi fizik apo juridik)	Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës dhe nr. i tel	Adresa	Lokacioni i objektit	Kapaciteti i derivateve		
					Naftë V=	Benzinë V=	GLN V=
1	“IP-KOS” Sh.P.K 1	Fatmir Kurteshi- menaxher 044 357 358	Gjilan	Rruga “Ferizajit”	3x30000	1x50000	10000
2	“IP-KOS” Sh.P.K 2	Albenis Sylejmani- menaxher 044 820 510	Gjilan	Rruga “Bujanocit”	4x30000	1x50000	10000
3	“Albapetrol Group” Sh.P.K	Alban Sadiku 049 808 028	Gjilan	Rruga “Malishevës”	1x50207 1x50975 1x25141	1x49842 1x25456	10000
4	“Albapetrol Group” Sh.P.K	Alban Sadiku 049 808 028	Gjilan	Doberqan	1x21000 1x16000	1x16000 1x16000	5000
5	“Albapetrol Group” Sh.P.K	Alban Sadiku 049 808 028	Gjilan	Lagjja “Arbëria”	1x32936 1x29293	1x 26933	10000
6	“Albapetrol Group” Sh.P.K	Alban Sadiku 049 808 028	Gjilan	Rruga “Ferizajit”	1x60000 1x62122 1x25000	1x25000	10000
7	“Albapetrol Group” L.L.C	Alban Sadiku 049 808 028	Gjilan	Zhegër	1x20438 1x26600	1x26476	5000
8	“Comany Ardhmëria” SH.A	Naim Zeneli - pronar 045 547 513	Gjilan	Malishevë	1x60447 1x30080 1x29690 1x30012	1x30202	
9	“Kamberi petrol” Sh.P.K	Xhavit Muji- menaxher 044 132 646	Gjilan	Bresalc	1x49600	1x48500	6400
10	“Bujana petrol” Sh.P.K	Flamur Shabani - menaxher 044 132 646	Gjilan	Gjilan	2x50000	2x30000	10000
11	“Dema Comerc” Sh.P.K	Rexhep Sejdiu - menaxher	Gjilan	Zhegër	1x29481 1x10684	1x40092	10000
12	“Ex-fis” Sh.P.K	Agim Brersovci - menaxher 044 144 032	Gjilan	Bresalc	2x52000	1x52000	

13	“Ex-fis” Sh.P.K	Agim Brersovci - menaxher 044 144 032	Gjilan	Gjilan	<b>1x22000</b>	<b>1x22000</b>	
14	“Ex-fis” Sh.P.K	Ardit Qerimi- menaxher 045 481 690	Gjilan	Gjilan	<b>1x14972</b> <b>1x15013</b>	<b>1x14966</b> <b>1x14894</b>	<b>5000</b>
15	“HIB-PETROL” Sh.P.K	Arbër Hasani- menaxher 044 433 191	Gjilan	Shillovë	<b>1x59956</b> <b>1x59963</b>	<b>1x29973</b> <b>1x29998</b>	<b>18000</b>
16	“Shaqa” Sh.P.K	Haki Shaqiri- pronar 044 322 414	Gjilan	Rr: “Ferizajit”	<b>1x60000</b>	<b>2x50000</b>	
17	“Petrol-Olti- Slovenija” L.L.C	Alban Halilaj- jurist 049 773 285	Gjilan	Rr: “Bujanocit” Shillovë	<b>1x50000</b>	<b>1x50000</b>	<b>5000</b>
18	“Petrol Company” Sh.P.K	Besim Sylejmani- menaxher 049 229 190	Gjilan	Rr: “Prishtinës”	<b>1x20000</b>	<b>1x20000</b>	<b>10000</b>
19	“Burimi Petrol” N.T.P	Fehmi Rexhepi- menaxher 045 570 840	Gjilan	Rr: “Bujanocit” Shillovë	<b>1x51600</b>	<b>1x52300</b>	
20	“Transshped” N.T.T	Nijazi Starrabaj- menaxher 049 131 482	Gjilan	Rr: “Qarkore”	<b>2x50000</b>	<b>1x50000</b>	<b>10000</b>
21	“Gani” N.T.P	Fevzi Hajrullahu- pronar 044 628 251	Gjilan	Velekincë	<b>1x56774</b> <b>1x56729</b>	<b>1x56626</b>	<b>15000</b>
22	“NABI-I-PETROL” Sh.P.K	Agim Ismajli 044 910 329	Gjilan	Malishevë	<b>1x15000</b>	<b>1x15000</b>	
23	“Beki Benz” N.T.P	Agim Hoti – pronar 044 154 165	Gjilan	Kmetoc	<b>1x25279</b> <b>1x25875</b>	<b>1x25948</b>	<b>5000</b>
24	K.P.T.Sh “Autogeni-Ada-Gas Company” Sh.P.K	Ridvan Murati – pronar 044 211 916	Gjilan	Rr:”Qarkore”	<b>1x25000</b>	<b>1x25000</b>	<b>100000</b>
25	“Ceni Compani” N.T.P	Ndririm pronari	Gjilan	Lladovë	<b>1x50000</b>	<b>1x50000</b>	<b>5000</b>
26	“Al Petroll”3	Shabi Shabani – menaxher 049 133 148	Gjilan	Rr:”Prishtinës ”	<b>1x49977</b> <b>1x48869</b>	<b>1x25153</b> <b>1x25481</b>	<b>6500</b> Nuk e përdor
27	“Al Petroll” 2	Bujar Shkodra – zv.menaxher 044 574 894	Gjilan	Rr:”Bujanocit ”	<b>1x29986</b> <b>1x29921</b>	<b>1x15098</b> <b>1x15819</b>	<b>15000</b>
28	“Al Petroll”1	Bujar Shkodra – zv.menaxher 044 574 894	Gjilan	Rr:”Prishtinës ”	<b>1x20004</b> <b>1x25297</b>	<b>1x25360</b>	<b>12000</b>

29	“Borovci Oil” Sh.P.K	Artan Borovci – pronar 044 534 861	Gjilan	Rr:”Bujanocit ” Kmetoc	<b>1x57395</b> <b>1x57418</b>	<b>1x57500</b> <b>1x28800</b>	
30	“Puls Oil” P.P	Milenkovic Zlata – pronar 064 4279 026	Gjilan	Shillovë	<b>1x15085</b>	<b>1x15125</b>	<b>5000</b>
31	“VEDA-3” N.P.T	Dashnim Kryeziu – pronar 044 655 554	Gjilan	Velekincë	<b>1x25000</b>	<b>1x25000</b>	<b>10000</b>
32	“VEDA-3” N.P.T	Dashnim Kryeziu – pronar 044 655 554	Gjilan	Gjilan	<b>1x26623</b> <b>1x26364</b>	<b>1x24668</b> <b>1x24213</b>	<b>16000</b>
33	“VEDA-3” N.P.T	Dashnim Kryeziu – pronar 044 655 554	Novobërdë	Rr:”Prishtinës ” Koretishtë	<b>1x25000</b>	<b>1x25000</b>	<b>15000</b>
34	“VEDA-3” N.P.T	Dashnim Kryeziu – pronar 044 655 554	Novobërdë	Rr:”Qarkore” Koretishtë	<b>1x14992</b>	<b>1x14975</b>	<b>13000</b>
35	“Beki Benz” N.T.P	Agim Hoti – pronar 044 154 165	Novobërdë	Rr: “Prishtinës” Koretishtë	<b>1x81991</b> <b>1x51443</b> <b>1x51151</b>	<b>1x51176</b>	<b>5000</b>
36	“COMPACT PETROLL” Sh.P.K	Saqip Shala – pronar 044 125 601	Novobërdë	Rr: “Prishtinës” Koretishtë	<b>1x30085</b> <b>1x30101</b> <b>1x60068</b>	<b>1x30085</b> <b>1x29978</b>	<b>4850</b>



Territori i Komunës së Gjilanit përbehet prej lagjeve urbane dhe fshatrave dhe vendbanimeve të ndara sipas zonave të kadastrave. Qyteti i Gjilanit njihet edhe si qendra e rajonit të Anomoraves, apo si qendra e trekëndëshit të dyfishte me të cilët lidhet me shtetet fqinje, nga kjo shihet se ka një pozite të volitshme gjeostrategjike.

Stacioni Policor në Gjilan mbulon si zone të përgjegjësisë se saj për të ofruar siguri për qytetarët në të gjitha territorin administrativ të komunës.

Komuna e Gjilanit është mjaft e ekspozuar përballë një numri të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish që mund të vijnë si rrjedhojë e veprimtarisë njerëzore.

Stacioni Policor Gjilan ka hartuar Planet Operative për të gjitha llojet e fatkeqësive natyrore që mund të ndodhin në zonën e përgjegjësisë se SP Gjilan. Po ashtu kemi edhe Planin Operativ Emergjent për Komunën e Gjilanit të hartuar në muajin maj të vitit 2022. Sipas këtij plani, roli dhe fusha e zbatimit të Policisë së Kosovës është si vijon:

1. Mbajtja e Rendit dhe Qetësisë Publike;
2. Kontrollimi i trafikut (përfshirë monitorimin e rrjedhës së trafikut, zbatimin e kufizimit të qarkullimit);
3. Kontrolli i zonave të kufizuara (gjegjësisht hyrjet dhe daljet nga zona e caktuar si situatë emergjente);
4. Ruajtja e Objekteve jetike;
5. Sigurimi i çdo vendi apo objekti të operimit fushor,
6. Mbeshtetja e vlerësimit të dëmeve,
7. Nderlidhja dhe koordinimi me zbatuesit tjerë të ligjit,
8. Kërkim Shpëtimi,
10. Identifikimi i fataliteteve,
11. Mbeshtetja e shpëtimit ajror,
12. Mbeshtetja e shpëtimit mjekësor,
13. Këshillimin e grupeve të politikave, koordinimit dhe operacioneve;
14. Këshillimi i grupit të politikave lidhur me anulimin e ngjarjeve, kufizimet, etj;
15. Menagjimi i rikthimit në gjendjen normale;
16. Asistimi i Qendrës së Informimit të Përbashkët (QIP) me shpërndarjen e informacionit publik emergjent.

## Objektet e rëndësisë së veçantë<sup>12</sup>

Në aspektin e sigurisë si objekte të rëndësisë së veçantë gjatë meningjtit të emergjencave dhe në rast të aktiviteteve subversive dhe terroriste ndaj vendit tonë (Në këto raste qëllimi i armikut është shkaktimi i sa me shume dëmeve njerëzore dhe infrastrukturore me pasoja të mëdha për popullatën) mund të renditen objektet me frekuentim të madh të njerëzve si vijon:

### 1. Objektet e pushtetit vendor komunal:

- Objekti i Komunës së Gjilanit;
- Objektet e Drejtorive Komunale;
- Objekti i Ekohigjienës;
- Objektet e sistemit të furnizimit me ujë – Hidromora;

### 2. Objekti i Njësisë së Zjarrfikëse dhe të Shpëtimit.

### 3. Objektet shëndetësore:

- Spitali Regjional,
- Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF),

### 4. Objektet shkollore:

- Universiteti Publik Kadri Zeka,
- Kolegji UBT,
- Kolegji Fama,
- Shkollat e Mesme,
- Shkollat fillore,
- Institucionet parashkollore të Edukimit

### 5. Liqenet artificiale:

- Liqeni i Perlepnices;
- Liqeni i Livoçit.

### 6. Posta:

- Posta e Madhe,
- Posta e Vogël.

### 7. Qendrat Tregtare:

- Qendra Tregtare ETC,
- Qendra Tregtare Interex,
- Qendra Tregtare Viva 5 objekte,
- Qendra Tregtare Agmia,
- Qendra Tregtare Drini,

### 8. Objekti i Prokurorise.

### 9. Objekti i Gjykates,


### 10. Objekti i MPB,

### 11. Objektet e Sigurisë:

- Objekti i Drejtorisë Rajonale të Policisë,
- Objekti i Stacionit Policor,
- Objekti i Nën Stacionit Policor Zhegër,
- Kazerma Ushtarake,
- Antenat dhe repetitorët difuzeve te Maja e Gjelbër (Zone e përgjegjësisë se SP Novobërdë por që interferon në zonën tonë) dhe te Kodra e Dëshmoreve.

### 12. Qendra Operative Rajonale Emergjente.

<sup>12</sup> Të dhënat: Stacioni Policor Gjilan, mars 2023



Në komunën e Gjilanit shërbimet postare kryhen kryesisht përmes postës, e cila është aset publik i Republikës së Kosovës dhe selia qendrore ndodhët në rrugën “Adem Jashari”. Ky shërbim ka filialet e veta të shpërndara një në lagjen “Dardania”, një në rrugën “Isa Boletini” (afër stacionit të autobusëve) dhe një në fshatin Zhegër. Personeli i postës përbëhet prej 32 personave, të cilët ofrojnë shërbime në sportele nga ora 08:00 deri në orën 20:00.

- Në rrugën “Adem Jashari” janë të përqendruara selitë e institucioneve private financiare – bankat “Raiffeisen” dhe “NLB”
- Në rrugën “Esat Berisha” ndodhen filialet e bankës “TEB”, dhe të “BPB”  
Në rrugën “Nëna Tereze” ndodhen filiatet e bankave “BKT” dhe “Prokredit bank”.
- Në rrugën “Ibrahim Rugova” ndodhët edhe selia e Administrata Tatimore e Kosovës

Në komunën e Gjilanit, gjithashtu janë filialet e të gjitha agjencive të sigurimeve që operojnë në republikën e Kosovës dhe janë të përqendruara kryesisht në rrugën “Lufta e Gjilanit” para dhe në afërsi të objektit të Gjykatës Themelore.





## Objektet shkollore

Objektet shkollore (parashkollore, shkolla fillore e ultë (SHFU), shkolla e mesme e ultë ( SHMU), e mesme dhe universitare);

### Infrastruktura shkollore

Në komunën e Gjilanit funksionojnë: 5 institucione parashkollore , 44 Shkolla fillore dhe te mesme te ulëta, 11 shkolla të mesme te larta. Shkollat fillore janë të shpërndara nëpër fshatra dhe lagje të qytetit, kurse shkollat e mesme dhe fakulteti janë të koncentruar në kompleksin e shkollave në rrugën “Zija Shemsiu”<sup>13</sup>.

#### Çerdhet e fëmijëve

Nr	Emri i çerdhës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i puntorëve
1.	Ardhmëria I “Thimi Mitko”	Gjilan	88	20
2.	Ardhmëria II	Gjilan	105	21
3.	Integj	Gjilan	122	22
4.	Dardania	Gjilan	132	46
5.	Bozhur	Shillovë	32	11
	<b>Gjithsej</b>		<b>479</b>	<b>120</b>

#### Shkollat e mesme

Nr	Emri i shkollës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i punëtorëve
1.	Zenel Hajdini – Gjinnazi	Gjilan	800	62
2.	Xhavit Ahmeti -Gjinnazi	Gjilan	888	59
3.	Marin Barleti – Ekonomike	Gjilan	535	68
4.	Dr. Asllan Elezi – Medicina	Gjilan	969	60
5.	Arbëria	Gjilan	156	47
6.	Muzikës	Gjilan	64	28
7	Adem Kastrati	Gjilan	131	22
8	Memet Isai – Teknike	Gjilan	379	73
7.	Mjekësisë	Shillovë		25
10.	Gjinnazi	Shillovë	216	
11	Marin Barleti p e ndare	Zheger		
	<b>Gjithsejt:</b>		<b>4.138</b>	<b>444</b>

<sup>13</sup> Të dhënat: Drejtoria Komunale e Arsimit - Gjilan

## Shkollat fillore

Nr	Emri i shkollës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i punëtorëve
1.	Salami Hallaqi	Gjilan	1.325	102
2.	Abaz Ajeti	Gjilan	985	76
3.	Musa Zajmi	Gjilan	818	69
4.	Thimi Mitko	Gjilan	1.213	110
5.	Rexhep Elmazi	Gjilan	746	66
6.	Lagja e 8	Gjilan	317	36
	Sadullah Brestovci	Gjilan	625	44
7.	Zabeli-zija Shemsiu	Gjilan	496	40
8.	Dëshmorët e Kombit	Livoq i Poshtëm	266	34
9.	Bajram Curri	Shurdhan	79	17
10.	Ramiz Cernica	Cernicë	270	47
11.	Agim Ramadani	Zhegër	531	80
12.	E. Berisha	Llashticë	155	28
13.	Mulla Idriz Gjilani	Velekincë	516	49
14.	Avdulla Tahiri	Malishevë	324	41
15.	Liria	Pogragjë	126	33
16.	Nazim Hikmet	Mirësh	231	55
17.	Skënderbeu	Perlepnice	295	45
18.	V. i Diturisë	Livoç i epërm	310	31
19.	Ibrahim Uruqi	Bresalc	265	37
20.	Afërdita	Kishnapole	78	29
21.	F. Qerimi	Vërbicë e Zhegocit	76	28
22.	Shkolla e muzikës	Gjilan	200	28
23.	Vesel Muji	Mihir	172	21
24.	Vehbi Ibrahim	Uglar	94	16
25.	Branko Radiqeviq	Cernicë		4
26.	Sveti Sava	Ponesh		9
27.	Vuk Karaxhiq – kom. serb	Gjilan – Kmetoc – Shillovë –Livoç		50
28.	N. Hikmet – komuniteti turk	Mirësh	16	12
29.	Musa Zajmi – komuniteti turk	Gjilan	7	7
	<b>Gjithsej:</b>		<b>10.536</b>	<b>1.244</b>

Nr	Emri i çerdhës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i puntorëve
1.	IEAPP “T –Nushe”	Gjilan	64	7
2.	IEAPP ‘HELLO”	Gjilan	150	20
3.	IEAPP “Poema”	Gjilan	80	20
4.	IEAPP “Fjoolla”	Gjilan	40	5
5.	IEAPP “Mësojtorja Qirijazi”	Gjilan	48	5
6.	IEAPP “Bota”	Gjilan	62	6
	Gjithsej		444	63

Nr	Shkollat Private	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i puntorëve
1.	“Hello Academy of Education	Gjilan		
2.	SHFM “Don Bosko	Gjilan		
	Gjithsej			

Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan	Numri i studentëve	Numri i stafit akademik dhe administrata		
		Të rregullt	Të angazhuar	administrata
		1.936	48	66

## KREU II-të Fatkeqësi natyrore

Fatkeqësitë natyrore janë fenomene të cilat shkaktojnë humbje me pasoja në popullatë, të mira materiale, mjedis dhe trashëgimi kulturore. Historiku i fatkeqësive natyrore në komunën Gjilanit, përfshinë fatkeqësi të shkaktuara nga tërmetet, vërshimet, zjarret malore-fushore, shtrëngata dhe breshër, thatësi, epidemitë.

Këto fatkeqësi kanë veprime periodike (tërmetet) si dhe sezonale. Tërmeti i fundit ka goditur Gjilanin në vitin 2002, kurse fatkeqësitë tjera janë sezonale dhe kryesisht ndikojnë në mjedis nga intenziteti i të reshurave (te vërshimet) dhe i thatësirave (te zjarret).

Komuna e Gjilanit, ka prioritet parandalimin e fatkeqësive natyrore sipas këtyre prioriteteve:

1. Tërmetet – zbatimi i maave të ndërtimit sipas mikrozonimit dhe standardet për evakuim në rast të tërmeteve;
2. Vërshimet – zbatimi i Ligjit për Ujrat; zbatimi i planeve rregulative dhe urbanistike të Komunës së Gjilanit; pastrimet periodike të shtretërve të prronjëve dhe lumenjëve.
3. Zjarret – shtimi i masave për ruajtjen e pyeve; aplikimi i masave ndëshkimore për zjarrvënje; masat senzibilizuese për parandalimin e zjarreve;
4. Fatkeqësitë tjera; zbatimi i ligjeve në fuqi për masat parandaluese kundër zjarreve, konform “Elaborateve të Mbrojtjes nga Zjarri” në objektet publike; të banimit kolektiv; në shkolla dhe biznese private...

Nga analiza e të dhënave dhe historiku i ngjarjeve, Komuna e Gjilanit është periodikisht e cënueshme nga vërshimet. Territorin e Komunës së Gjilanit e përshkon lumi Morava e Binçës, i cili mbledhë gjithë lumenjtë e vegjël, me një prurje mesatare ujore prej 6.7 m<sup>3</sup>/s. Qyteti i Gjilanit përshkohet edhe nga tre lumenj të vegjël: Dobrusha, Stanishorka dhe Baja. Prurja maksimale e ujit të lumit Dobrusha është 0.22 m<sup>3</sup>/s, ndërsa sipërfaqja grumbulluese është 11.07 km<sup>2</sup>. Lumenjtë Stanishorka dhe Baja janë më të vegjël për nga prurja e ujit .

Lumenjtë të cilët kalojnë nëpër vendbanime në pjesët rurale siç janë: “Morava e Binçës”, lumenjtë: Livoçit, Cernicës, Bresalcit, Zhegrës, Llashticës dhe Përlepticës.

Nga evidenca, në vitin 2014, ka pasur 56 familje të prekura, 2015 mbi 46 familje, në vitin 2016 ka pasur 23 familje, në vitin 2017 vetëm kemi 4 raste, kurse në gjashtëmujorin e parë të 2018 janë të prekura 17 familje dhe ambiente biznesi.

Për shkak të intervenimeve në shtretit e këtyre lumenjëve, janë zvogëluar minimalisht efektet e prurjeve. Në lumenjtë e fshatrave, prurjet janë të rritura gjatë sezonit të pranverës, vjeshtës dhe dimrit. Vërshimet kryesisht ndodhin gjatë pranverës dhe vjeshtës. Lumenjtë dhe përroskat të cilat janë të njohura për vërshime janë ato që rrjedhin nëpër fshatrat: Shurdhan, Pidiq, Demiraj, Zheger, Nasalë, Velekincë, Malishevë, Uglarë, Dobrqan, Bresalc, Livoç i Epërm, Livoç i Ulët, Sllubicë, Pogragjë.

## Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet:

	Lumenjtë	Lokacioni i vërshimeve (lagja, fshati...)	Gjendja në lokacion	Sip. të mundshme për vërshime	Infrastrukturë	Resurset për angazhim (humane dhe teknike)
1	Stanishorka	Pjesa urbane e qytetit të Gjilani: <b>Porodini:</b> 51 shtëpi, 204 banorë <b>Vishnet:</b> 53 shtëpi, 212 banorë <b>Livadhet e Arapit:</b> 60 shtëpi, 240 banor; <b>Malishevë</b> 42 shtëpi, 168 banor.	206 ekonomi familjare, katet përdhese të shtëpive të banimit, oborre, sera dhe tokë bujqësore	Gjatësi 5.7 km	1 trafo; 10 biznes 2 pemishte. 5 pikë karburanti. 1 Shtëpi e shëndetit mental; 7 ura	Te mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes
2	Morava	Fshati Nasalë	Tokë bujqësore, ara dhe livadhe	10 hektarë	/	Te mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes
3	Livoçi	Livoç i Epërm Liviç i Poshtëm	80 ekonomi familjare, katet përdhese të shtëpive të banimit, oborre, sera	3.10 km	5 ura	
4	Sllubicës	Sllubicë	30 ekonomi familjare, katet përdhese të shtëpive të banimit, oborre, sera Dhe tokë bujqësore	3.00 km	5 ura	Te mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes

**Zonat, vendbanimet të prekura nga vërshimet në 10 vitet e fundit, banorët dhe detajet në lidhje me lokalitetet që preken.**



## Karakteristikat hidrografike

### Ndikimet e saj në paraqitjen e vërshimeve

Lumenjtë dhe përroskat e Komunës së Gjilanit kanë origjinë nga malet e afërta. Zonat e prira për përmbytje janë sipërfaqe të rrafshëta pranë lumenjve. Në të kaluarën lumenjtë/përroskat shfrytëzoheshin për ujitjen e tokave bujqësore. Zhvillimet e fundit kanë ndryshuar shfrytëzimin e tokës nga ajo bujqësore në tokë ndërtimore. Pjesa dërmuese e sistemit të ujitjes dhe kanaleve, që në një formë ishin drenazhim natyral, janë ndërprerë ose janë mbuluar duke ndërprerë rrjedhën (kullimin) e ujit dhe si pasojë uji qëndron në vend, duke shkaktuar dëme nëpër oborret e shtëpive dhe në të mbjella, në tokat që shfrytëzohen për bujqësi.

Territori i komunës së Gjilanit i nënshtrohet përmbytjeve/vërshimeve, kryesisht për shkak të kapaciteteve të ngushta akumuluese të lumenjve, ndonjëherë nga punimet ndërtuese të infrastrukturës.

#### Historiku i vërshimeve ( koha, hot-spotet/pikat e nxehta);në Komunën e Gjilanit


Vërshimet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	√	√	√	√	√						√	√

*Periudhat e rrezikut nga vërshimet:*

Zonat (vendbanimet) më të rrezikuara janë:

- Lumi Stanishorka, vërshon lagjet Porodin, Fidanishte, Livadhet e Arapit, fshatin Malishevë, deri në derdhje në lumin Morava e Binçës;
- Përroni e Shillovës grumbullon rredhën natyrore që vie nga kodrat e fshatit Kufcë, e përshkon rrugën magjistrale Gjilan – Bujanoc të pika e karburantit “Hib Petrol” ku dhe e vërshon këtë pjesë, pastaj vazhdon deri në derdhje në lumin Stanishorka, në hyrje të fshatit Malishevë;
- Lumi i Livoçit, vërshon qendrat e fshatrave Liviç i Epërm dhe i Ulët;
- Lumi i Sllubicës, vërshon toka bujqësore përgjat lumit deri në fshatin Pogragjë;
- Lumi Morava vërshon tokë bujqësore në fshatin LLadovë.


# Vërshimet





Vërshimet me 20.11.2022, dalja nga shtrati e lumit Stanishorka dhe përroi i Shillovës





Niveli i ujit në qendër të fshatit Shillovë i shkaktuar nga prroi i Shillovës



Niveli i ujit në katin përdhes të një shtëpie banimi në lagjen Porodin, shkaktuar nga vërshimi i lumit Stanishorka



## Kushtet hidrometeorologjike

### Të dhënat për disa parametra klimatik për komunën e Gjilanit<sup>14</sup>


Parametrat	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjet
1 Lagësh. e ajrit %	84.7	75.0	71.3	65.7	65.3	62.7	60.7	68.0	71.7	74.7	78.3	85.0	71.9
2 Reshjet në mm	40.5	36.3	40.5	44.7	60.7	49.6	56.1	50.8	71.2	46.1	52.5	54.9	603.7
3 Vranësirat në të dhjetat	7.5	4.9	5.7	5.3	4.7	3.0	3.3	4.2	4.7	4.9	5.6	8.4	5.2
4 Temperaturat °C	-0.5	1.7	4.9	10.3	15.1	18.6	20.3	19.8	16.0	10.9	5.8	1.2	10.4

### Sasia e reshjeve në mm, sipas stineve të vitit në Gjilan

Stacioni	Dimër	%	Pranverë	%	Verë	%	Vjeshtë	%	P.vegje.	%	
	Gjilan	131.7	21.8	145.9	24.2	156.5	25.9	169.8	28.1	100	333.1

### Rastisja dhe shpejtësia e Erës për Gjilanin

Stacioni	Veriu (N)		Verilindje (NE)		Lindje (E)		Juglindje (SE)		Jugu (S)		Jugperëndimi (SW)		Perëndimi (W)		Veriperëndim (NW)		C
	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	
	Gjilan	251	1.47	233	1.77	15	1.8	90	2.1	29.7	1.8	72.3	1.47	93	1.43	154	



<sup>14</sup> Të dhënat: Instiruti Hidrometeorologjik i Kosovës



Masat që zvogëlojnë efektet nga vërshimet, kryesisht kanë të bëjnë me mbikëqyrjen nga komuna të zbatimit të Ligjit për Ujrat; zbatimin e planeve rregulative dhe urbanistike të Komunës së Gjilanit; ndalimin e mbylljes së rrjrdhave natyrore; pastrimet periodike të shtretërve të prronjëve dhe lumenjëve, kanalizimin e ujërave atmosferik.

Këto masa, me prioritet duhet të ndërmerren në:

### **1. Rrjedhën e lumit të Stanishorit deri në dalje të fshatit Malishevës, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

- a) Rikthimi i vijës së rrjedhës në pozicionin para devijimit sipas hartave kadastrale;
- b) Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin të lumit;
- c) Ndërtimi i një ure te rruga qarkore, e cila bërballon prurjet e lumit si dhe të proit të Kufcës;
- d) Mirmbajtja – pastrimi periodik i urërës e cila pret rrugën Gjilan – Malishevë;
- e) Thellimi i shtratit të lumit nga hyrja e fshatit Malishevë, vendosja e një drenazhimi dhe ujlëshesave që kullojnë kodrën e Malishevës, si dhe ngritja e nivelit të rrugës në hyrje të fshatit Malishevë.
- f) Hapja e vijës së rrjedhës së proit të Shillovës, duke filluar nga rruga Magjistrale Gjilan – Bujanoc (te pika e karburantit Hib petrol), e deri te në derdhje, aty ku bashkonen lumi Mirusha dhe Stanishorka.

### **2. Lumi Baja**

#### **Masë e qëndrueshmërisë:**

- a). Krijimi i bajpasit të shkarikimit emergjent të këtij lumi, duke filluar nga biblioteke e qytetit, përgjat rrugës “Abdullah Tahiri”, dhe shkarkimi pran urës te karzerma, në lumin Stanishorka në gjatësi prej  $L=300\text{m}$ .
- b). Zgjërimi i kanalit ekzistues, duke filluar nga poliklinika “Diagnoz” dhe devijimi përgjatë rrugës “Tregu” deri në lumin Shtanishorka, me gjatësi  $L=300\text{ m}$ .

### **3.Lumi Mirusha**

Masë e qëndrueshmërisë:

- a) Lumëi është trajtuar në pjesën më të madhe, duke filluar nga lagja “Dardania” deri në dalje të qytetit, te “Livadhet e Arapit”. Trajtimi është bërë duke u krijuar kanali i betonit, i cili është mbuluar. Për të mirmajtur rrjedhën në afat të gjatë, është më se e nevojshme që në hyrje

të lumit, para se lumi të hy në kanalën e mbuluar, të krijohen puseta apo impianti, i cili i ndal materialet inerte dhe mbeturinat tjera.

**4. Përroi i Kufcës që përfshihet prej daljes së fshatit Kufcë e Epërme, e deri te shkarkimi në lumin e Stanishorit, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

- a) Largimi i ujë-lëshesave ekzistuese dhe vendosja e atyre adekuate me prerje tërthore në harmoni me shtratin e përroit;
- b) Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin e përroit.
- c).Rikthimi i vijës së rrjedhës në pozicionin para devijimit sipas hartave kadastrale

Masat e qëndrueshmërisë:

- a) Rregullimi i shtratit të kanalit.

**5. Rrugës magjistrale nga udhëkryqi i rrugës qarkore e deri te rruga e Përlepnicës, nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

**Masa të ngutshme:**

- a) Hapja e kanaleve përgjatë rrugës magjistrale;
- b) Largimi i ujë-lëshesave ekzistuese dhe vendosja e atyre adekuate me prerje tërthore në harmoni me shtratin e kanalit;
- c) Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në mbushjen e kanaleve dhe ujë-lëshesave

Masat e qëndrueshmërisë:

- a) Hapjen e rrjedhës natyrore të ish fabrika e Baterive deri në bashkimin me proin e Shillovës;

**6.Përroi i Kosaqës, nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

**Masa të ngutshme:**

- a) Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin e përroit.
- b) Largimi i ujë-lëshesave ekzistuese nga shtrati i përroit, të vendosura nga pronarët e restoraneve në hapësirën nga rruga e Përlepnicës deri në hyrje të fshatit Kmetoc dhe, zgjerimi i shtratit të përroit në harmoni me hartat kadastrale.

**7. Kmetoc, Lumi i Përlepticës, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

Masa të ngutshme:

- a). Pastrimi dhe ulja e nivelit të shtratit të lumit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë e tjera), prej fillimit të rrjedhës të lumit Përlepnica deri në hyrje të fshatit Dobërqan;
- b). Largimi i ujë-lëshesave ekzistuese nga shtrati i lumit në dalje të fshatit Dobërqan dhe zgjerimi i shtratit të lumit në këtë vend;
- c). Pastrimi i shtratit të lumit në dalje të fshatit Dobërqan (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë dhe aluvionit) me qëllim të formimit të shtratit të rregullt të lumit në gjatësi  $L= 8.000$  metra;
- d). Hapja e kanalit përgjatë rrugës magjistrale në pjesën ku kalon edhe jazi;
- e). Pastrimi dhe hapja e 2 ujë-lëshesave ekzistuese në trupin e rrugës;
- f). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin e lumit.

Masat e qëndrueshmërisë:

- a). Mënjanimi i devijimit në pjesën e epërme të urës në fshatin Kmetoc dhe në pjesën e poshtme të urës ku ka mbushje;
- b). Mënjanimi i mbushjeve dhe zgjerimi i shtratit të lumit në harmoni me hartat kadastrale nga fabrika “Kabi” deri në hyrje të fshatit Dobërqan.

**8. Rruga “Idriz Seferi” deri në fshatin Livoq i Poshtëm, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

Masa të ngutshme:

- a). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në mbushjen e kanaleve dhe ujë-lëshesave;

Masat e qëndrueshmërisë:

- f). Hartimi i projektit zbatues të ujërave atmosferike për rrjedhën ujore që shkarkon ujërat nga kodra e Gjilanit dhe Velekincës në lumin e Livoqit dhe implementimin e tij.

**9. Fshati Livoq i Epërm**

**Masa të ngutshme:**

- a). Pastrimi dhe ulja e nivelit të shtratit të lumit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë e tjera), nga hyrja në fshatin Livoq, e deri të dalje të fshatit, te ura e Cërnicsës, në gjatësi  $L= 3.300$  m.

**Masat e qëndrueshmërisë;**

a). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në mbushjen e lumit me mbeturina inerte dhe organike përgjatë gjithë gjatësisë, nga fillimi i fahstit deri te Ura e Cërnicës;

**10. Fshati Livoq i Poshtëm**

Masa të ngutshme:

a). Pastrimi dhe ulja e nivelit të shtratit të lumit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë e tjera), nga hyrja në fshatin Livoq, e deri të dalje të fshatit, te ura e Cërnicës, në gjatësi  $L=2.300$  m.

Masat e qëndrueshmërisë;

a). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në mbushjen e lumit me mbeturina inerte dhe organike përgjatë gjithë gjatësisë, nga fillimi i fahstit deri te Ura e Cërnicës;

**11. Magjistralla Gjilan-Ferizaj, te ura e lumit Cërrnica, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

- a). Hapja e kanaleve përgjatë rrugës magjistrale Livoq i Poshtëm- Ura e lumit të Cërnicës;
- b). Pastrimi dhe hapja e ujë-lëshesave ekzistuese në trupin e rrugës;
- c). Pastrimi i shtratit të lumit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë dhe aluvionit) me qëllim të formimit të shtratit të

rregullt të lumit në gjatësi  $L= 700$  Metra.

**12. Gumnisht, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

Masa të ngutshme:

- a). Pastrimi dhe ulja e nivelit të shtratit të përroit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë e të tjera), në pjesën përgjatë fshatit.  $L= 1.000$  Metra;
- b). Ndërtimi i urave sipas standardeve;
- c). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin e përroit.

Masat e qëndrueshmërisë:

a). Mënjanimi i mbushjeve dhe zgjerimi i shtratit të lumit në harmoni me hartat kadastrale.

**13. Gadish, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

Masa të ngutshme:

- a). Pastrimi i shtratit të përroit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë të tjera), në pjesën përgjatë fshatit. L= 4.750 Metra;
- b). Ndërtimi i urave sipas standardeve;
- c). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin e përroit;  
Masat e qëndrueshmërisë:
- a). Mënjanimi i mbushjeve dhe zgjerimi i shtratit të lumit në harmoni me hartat kadastrale.

#### **14. Përroi në fshatin Bresalcë, ku nevojitet të ndërmerren masat vijuese:**

Masa të ngutshme:

- a). Pastrimi dhe hapja e ujë-lëshesave ekzistuese në trupin e rrugës L=1000 Metra;
- b). Largimi i ujë-lëshesave ekzistuese dhe vendosja e atyre adekuate me prerje tërthore në harmoni me shtratin e kanalit;
- c). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në mbushjen e kanaleve dhe ujë-lëshesave.

Masat e qëndrueshmërisë.

- a). Hapjen e rrjedhës natyrore.

#### **15. Fshati Sllubicë**

Masa të ngutshme:

- a). Pastrimi dhe ulja e nivelit të shtratit të lumit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë e të tjera), në pjesën përgjatë shtratit të lumit deri në hyrje të fshatit Pogragjë L= 3.000 Metra;
- b). Ndërtimi i 5 urave sipas standardeve;
- c). Ndërmarrja e masave ligjore për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në shtratin e e lumit, si dhe ndalimin e shfrytëzimit të eksplotimit të zhavorrit nga operatorët ilegal.


Masat e qëndrueshmërisë:

- a). Mënjanimi i mbushjeve dhe zgjerimi i shtratit të lumit në harmoni me hartat kadastrale.


#### **16. Fshati Nasal**

Masa të ngutshme:

- a). Rregullimi i argjinaturës së dëmtuar të lumit Morava;
- b). Ndërtimi i një ure të përshtatshme mbi lumin Morava, që mundëson lidhjen e fshatit me pronat bujqësore përtej lumit;
- c). Pastrimi i shtratit të përroit (largimi i mbeturinave të ndryshme, bimësisë të tjera), që përshkon gjithë gjatësinë e fshatit. L= 750 Metra;









01/08/2023 8:58 AM

© MSc. Gjeografisë Amir REXHA

Harta e rrezikut nga vërshimet - Pergjat lumit Stanishorka







Harta e rrezikut nga vërshimet  
 Zonat kadastrale: Livoç i Epërm, Livoç i Ulët, Cërnicë

01/08/2023 8:58 AM


© MSc. Gjeografisë Amir REXHA





Harta e rrezikut nga vërshimet - Zona Kadastrale Nasalë

01/08/2023 8:58 AM  
 © MSc. Gjeografisë Amir REXHA



### Masat e ndërmarra parandaluese

Me qëllim të zvogëlimit të rrezikshmërisë nga vërshimet, komuna e Gjilanit, gjegjësisht, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me 2023, ka realizuar tenderin “Pastrimi i lumenjëve dhe përronjeve”, në vlerën 100.000 euro. Aktiviteti ka filluar në dhjetor të vitit 2023 dhe deri në shkurt të vitit 2024, janë realizuar rekomandimet:

- Pastrimi i rrjedhës së e lumit të Stanishorit deri në dalje të fshatit Malishevës;
- Pastrimi i përroit të Kufcës që përfshihet prej daljes së fshatit Kufcë e Epërme e deri te shkarkimi në lumin e Stanishorit;
- Janë mënjanuar 120 m<sup>3</sup> mbetje plastike nga lumi Morava, në afërsi të Kalasë së Pogragjës;
- Janë në proces aktivitetet për pastrimin e pellgut të lumit të Livoqit, të Zhegrës, Përlepnicës dhe të Sllubicës.



*Pastrimi i lumit Morava nga mbetjet e plastikës*

### Rekomandimet:

1. Ndërtimi në përputhje me rregulloret komunale dhe ligjet;
2. Pastrimi periodik i shtretërve të lumenjëve;
3. Zbatimi i masave ndëshkimore ndaj atyre që hudhin mbeturina dhe lëndë ndotëse.



### Kushtet klimatike,

Territori i komunës së Gjilanit në kuptimin klimatik i nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme, të cilat gjatë muajve të verës shkaktojnë mungesë të reshjeve të shiut dhe lagështisë së ajrit dhe tokës. Për pasoj gjatë periudhës së verës, gjegjësisht në muajt qershor-shtator, territori i komunës përfshihet nga thatësia dhe temperatura të larta, vlerat e të cilave arrijn nivelin mesatar mujorë; në korrik 21,5°C dhe gusht me 21,0°C, me temperatura maksimale ditore deri në 38°C.

Kjo gjendje klimatike krijon parakushte të përhapjes së zjarreve në territoret e pyllëzuara dhe në fusha. Këto zjarre bëjnë pjesë në të ashtuquajturën “Ndodhitë sezonale”. Me rritjen e temperaturave në periudhën verore, rritet edhe rrezikshmëria nga shpërthimet e zjarreve në hapësira të hapura. Evidencat nga shërbimet profesionale (Inspektori i Preventives nga Zjarri), flasin se shkaktar kryesor i përhapjes së kësaj kategorie të zjarreve është faktori njeri, qofte nga pakujdesia apo me qellim.

Zjarre pyjore me përmasa me të mëdha ka pasur gjatë verës së vitit 2007, të cilat kanë përfshirë lokacioni e Stanqiq-Letnicë, Malishevë, Pasjan-Lashticë dhe Zhegër-Nasalë.

Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohë-zgjatja,

Zjarret	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
						√	√	√	√			

Historiku i zjarreve me intensitet të lartë në Komunën e Gilanit				
Muaji	Viti	Lokacioni	Tipi	Sipërf. (Ha)
Qershor	2007	Stanqiq - Letnicë	Zjarr malor	2.000
Prill	2007	Malishevë	Zjarr malor	30
Gusht	2007	Pasjan - Llashticë	Zjarr malor	50
Qershor	2007	Zhegër - Nasal	Zjarr fushor	100

Në dhjetë vitet e fundit, komuna e Gjilanit, më së shumti është ballafaquar me zjarret malore dhe fushore. Nga gjithsej 5.176 zjarre të ndodhura në këtë periudhë (2012 – 2022), zjarre

fushore kanë qenë 1.949, dhe malore 784. Këto shifra flasin se komuna e jonë është e ekspozuar më së shumti ndaj rrezikut që vije nga këto dy kategori të zjarreve. Faktori tjetër i cili këtë kategori të zjarreve e vë në rrezikun kryesorë është se ato zkonisht ndodhin në sezonin e verës, që për shkak të vjetacionit të tharë, mundësia e përhapjes së tyre është e shpejtë në kohë dhe hapësirë, gjë që pamundëson intervenim të njehershëm të njëjësive intervenuese.


Zonat më të atakuara nga zjarret fushore dhe malore janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, si dhe fshatrat e zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave. (Harta)

Treguesit statistikor të pasojave në periudhat kohore të zjarreve, muajt më kritik të zjarreve për 10-50 vitet e fundit, numrin dhe dëmet e përlllogaritura të zjarreve sipas rregullores për vlerësimin e dëmeve;

### Struktura dhe numri i zjarreve 2012 – 2022

Vitet		2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Gjith.
1	Shtëpi	52	44	58	65	68	60	31	28	38	74	62	
2	Obj. Kolek. Oxhaq.	17	5	13	10	8	10	43	46	39	8	13	
3	Lokale afariste	11	8	11	13	9	13	10	18	10	12	30	
4	Objekte Publike	10	2	4	/	2	1	1	2	1	1	/	145
5	Automjete	14	16	13	19	17	26	12	11	20	25	19	24
6	Pleme -Shtalla e tj.	12	6	7	10	1	9	2	11	2	6	1	192
7	Ushqim bagtish	9	9	12	6	1	1	1	2	/	1	4	67
8	Fushore	337	215	63	253	105	317	159	172	68	188	72	1.949
9	Mali / Pyjet	226	45	20	62	22	110	32	91	52	68	56	784
10	Trafost. rrjet. Elekt	14	9	6	9	14	5	4	11	19	26	30	147
11	Të Tjera	85	88	70	88	63	111	78	132	105	109	101	1030
<b>Gjithsej</b>		<b>787</b>	<b>447</b>	<b>277</b>	<b>535</b>	<b>310</b>	<b>663</b>	<b>373</b>	<b>524</b>	<b>354</b>	<b>518</b>	<b>388</b>	<b>5.176</b>

Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret fushore e malore		
	Kategoria	Sipërfaqe në km <sup>2</sup>
1	Rrezik i ulët	23.68
2	Rezik mesatar	299.54
3	Rrezik i ashpër	67.78



# Harta e rrezikut nga zjarret - Komuna e Gjilanit

02/08/2023 8:55 AM

© MSc. Gjeografisë Amir REXHA



## Masat parandaluese për zjarret

### Preventiva në zjarret malore dhe fushore

- Edukimi qytetar;
- Krijimi i tampon zonave – ndarjen e sipërfaqeve pyjore përmes lavrimit nga kontakti i drejtëpërdrejtë me sipërfaqet fushore, të cilat periodikisht digjen;
- Lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje shirjeve;
- Hapja e rrugëve malore për intervenim;
- Zbatimi i masave ndëshkimore për zjarrëvënsit.

### Masat parandaluese për zjarret industriale

1. Formimin e njësisë së zjarrfikësve industrial;
2. Subjektet private dhe publike të hartojnë Rregulloren për Mbrojtje nga Zjarri;
3. Pajisje të mjaftueshme (aparate dore) për fikjen e zjarrit;
4. Hidrantët të kompletuar në të gjitha hapësirat e parapara me ligj;
5. Sisteme për mbrojtje nga zbrazjet atmosferike
6. Lajmëruesit automatik të zjarrit;
7. Atestimi një herë në vit të këtyre sistemeve;
8. Sistemet pneumatike;
9. Gyp përcjellësit sipas rregullave;
10. Tym përcjellësit;
11. Ventilim;
12. Palosja në depo duhet bërë në ambalazhe dhe grumbull deri në 30 në një vend;
13. Lartësia e grumbullit mos te tejkaloi 3 m;
14. Krijimi i hapësirës së lirë për qarkullim;
15. Krijimi i distancave të mallrave nga poçet elektrike.





## TËRMETET

Në pikëpamje sizmologjike, Kosova paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrën të cekëta, gjenerojnë në koren e tokës, maksimum 15 – 20 km thellë në tokë.

Këto zona të burimeve sizmike në Kosovë kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen tërmete të fortë. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur Kosovën, me ndikim në regjionin tonë, po përmendim: Rajoni Ferizaj-Gjilan është prekur nga dy tërmete shumë të forta, më 1755 dhe 1921. Tërmeti i vitit 1921, me të njëjtin intensitet prej 9 ballë me atë të vitit 1755, çka do të thotë se është përsëritur pas 166 vjetësh. Tërmeti i vitit 1921, është shoqëruar nga shumë pasgoditje të forta 7 e 8 ballë shkalla MCS, që kanë zgjatur për një vit, nga gushti 1921, deri më shtator 1922.

Karakteristike është se në rajonin Ferizaj-Gjilan janë regjistruar tërmetet me magnitudë nën 5.0 shkallë të Riterit dhe intensitet në epiqendër rreth 6–7 ballë, me sa vijon:

- Tërmeti i 5 marsit 1936 me magnitudë 4.9 dhe intensitet në epiqendër 6-7 ballë
- Tërmeti i 8 qershorit 1956 me magnitudë 4.6 dhe me intensitet në epiqendër 6 ballë.

Nga kjo shihet se pas vitit 1956 nuk është regjistruar ndonjë termet me intensitet në epiqendër 6 ose mbi 6 ballë. Dhe vetëm më 24 prill 2002 një termet me intensitet në epiqendër prej 7.5 ballë MSK-64 goditi rajonin e Gjilanit.

Nga goditja e këtij tërmeti kishte një viktimë (46 vjeçar), 2 persona të lënduar rëndë, 54 të lënduar lehtë, si dhe u dëmtuan 3.866 objekte të banimit privat, të kategorizuara<sup>15</sup>:

1. Objekte banimi kategoria 4-B = 1.396;
2. Objekte banimi kategoria 4-A = 1.513;
3. Objekte banimi kategoria 3-B = 1.187;
4. Objekte banimi kategoria 3-A = 2.679.

Nga kjo konstatojmë se: ky termet është përsëritur këtu pas 46 vitesh nga tërmeti 6 ballësh i vitit 1956 dhe, pas 66 vitesh nga tërmeti 6-7 ballësh i vitit 1936.

Kjo histori e ndodhive vërteton se territori i Kosovës, për nga pikëpamja sizmike, paraqet një vend aktiv me rrezikshmëri sizmike të lartë, njëlloj si vendet fqinje.

Sizmiciteti i lartë i Kosovës dhe tërmeti i 24 prillit 2002, që preku Rajonin e Gjilanit, sikur edhe tërmetet e kohë pas kohë të cilat ndodhin në vazhdimësi, duhet të evidentohet si çështje e dorës së parë, e cila kërkon zgjedhje të nevojave urgjente për ngritjen e shërbimeve sa më të mira emergjente, për tejkalimin e situatave të tilla.


<sup>15</sup> Raport; “Komisioni për Gadishmëri Emergjente”, DMSH – Gjilan, 22.10.2002.


### Raporti Vjetor 2008


Duke u bazuar në të dhënat e Rrjetit Sizmologjik të Kosovës , EMSC dhe Rrjeteve Sizmologjike të vendeve të Rajonit, Zyra për Sizmologji, gjatë kësaj periudhe ka bërë monitorimin e ngjarjeve sizmike, regjistrimin si dhe përpunimin e parametrave të tërmeteve në vend dhe rajon.

Gjatë kësaj periudhe vjetore kanë ndodhur 214 tërmete, 151 tërmete kanë qenë të rajonit, ndërsa 63 tërmete në Kosovë. Vetëm në Komunën e Gjilanit kanë ndodhur 20 tërmete pra 1/3 edhe atë: 1.5 deri 2.5 shkallë 15, prej 2.5 deri 3.5 shkallë 3 dhe prej 3.5 deri në 4.4 shkallë 2 tërmete.










Epiqendrat e tërmeteve të ndodhura në Komunën e Gjilanit





## Masat parandaluese për rrezikun nga tërmetet

### 1. Aplikimi i kodit të ndërtimit dhe respektimi i rregullave bazë për rezistencë ndaj ndikimeve sizmike bëhet:

Masa për përballimin e ndikimeve nga tërmeti në komunën e Gjilanit, janë të përfshira në manualin "Mikrozonimi Sizmik i Gjilanit", i hartuar me 2012, që trajton komplet zonën e Gjilanit<sup>16</sup>

Për projektet e dorzuara për paisje me leje ndertimore, të bëhet trajtimi i pjesës së strukturës. Gjatë llogarive trajtohet objektet për përballimin e ndikimeve seizmike sipas Eurokodit EC -8.

Qëllimi kryesor i përfilljes së rregullave për ndërtim të qëndrueshëm ndaj tërmeteve është që në rast të ndonjë tërmeti në të ardhmen të mos ketë humbje në njerëz dhe dëmet materiale të jenë sa më të vogla dhe të riparueshme. Për t'u përmbushur kjo objektivi duhet ndërmarr këto veprime:

- Organizimi i fushatave periodike (punëtori, simulime) për vetëdijesimin e popullatës për rreziqet nga tërmetet.
- Fuqizimi i kapaciteteve komunale për kontrollimin e zhvillimeve në aspekt të ndërtimit rezistues nga forcat sizmike. Koeficientet sizmik si edhe parametrat e tjerë do të përcaktohen me anë të studimeve të veçanta sizmike të ashtuquajtura "mikrozinim i hapësirave ndërtimore". Kontrolli duhet të verifikojë nëse objekti i cili do të ndërtohet përfillë masat për rezistencë ndaj tërmeteve për zonën dhe pozitën e dhënë.

### 2. Analizat inxhinierie dhe hapësinore për ndërtesat kritike dhe shfrytëzimi i hapësirave të tyre në rast fatkeqësie

Bazuar në analizat inxhinierie dhe hapësinore të identifikohen dhe vlerësohen objektet e përshtatshme që mund të shfrytëzohen si hapësira për evakuim në zonat të caktuara (shiko faqen...) Objektet e tilla të përshtatshme në qytet janë, shkollat, palestra sportive, etj.

### 3. Intervenimet në strukturën mbajtëse të objektet shumëkatëshe të banimit.

Me qëllim të adaptimit të njësive komerciale kryesisht në përdhese, është rritur cenueshëmëria ndaj ndikimeve sizmike. Këto intervenime janë bërë pa ndonjë studim specifik dhe pa miratimin e organeve kompetente. Pjesa ku më së shumti ka pas ndërhyrje të kësaj natyre janë objektet në qendër të qytetit përkatësisht objektet e vjetra të cilat ndodhën përgjatë rrugës "Ibrahim Rugova".

Rekomandime:

1. Kontrolli i vazhdueshëm i aplikimit të masave të parapara me ligj;
2. Formimi i një komision ekspertësh për të bërë vlerësimin profesional të gjendjes së 1396 objekteve, të cilat komisioni profesional, pas tërmetit të vitit 2002, i ka shpallur në kategori 4B (të pa banueshme)<sup>17</sup>.

<sup>16</sup> [https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/MIKROZONIMI\\_SIZMIK\\_I\\_GJILANIT.pdf](https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/MIKROZONIMI_SIZMIK_I_GJILANIT.pdf)

<sup>17</sup> Komuna e Gjilanit, "Tërmeti në Komunën e Gjilanit – Raport Tërmeti 15/0502", 3616/07, 24.05.202. arkivi DMSH





Objektet në të cilat është ndëryrë në strukturë

Nr.rendor	Nr.kadastral	Njësitë	Etazha
1	3662-0-5-0	109	P+5
2	3680-0-1-0	1	Xhami
3	5021-0-4-0	32	B+P+3
4	3708-0-3-0	24	P+2
5	4998-0-49-0	51	B+P+4
6	4985-0-48-0	50	P+4
7			
8	4387-0-47-0	31	P+4
9	4391-0-46-0	23	P+3
10	3759-0-27-0	18	P+3
11	3756-0-28-0	20	P+3
12	3756-0-29-0	16	P+3
13	3764-0-30-0	25	P+3

## RRËSHQITJET DHE EROZIONET

Erozioni është një proces natyror, i cili në masë të madhe ndikohet nga aktiviteti njerëzor. Shfrytëzimi i tokës në komunën e Gjilanit, shpyllëzimi dhe shtrirja urbane kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së erozionit. Përmirësimi i praktikave të shfrytëzimit të tokës mund të kufizojë erozionin duke rekomanduar sistemet ndërtimore, pyllëzimin dhe shtrirjen e kontrolluar të zgjerimit të vendbanimeve.

Komuna e Gjilanit nuk karakterizohet me shkallë të lartë të erozionit. Territori i identifikuar me shkallë të lartë të erozionit (afërsisht 9 % të territorit të komunës) gjendet në pjesën veriore dhe jugore të territorit.

	Përshkrimi	Sipërfaqja
I	Erozion shumë i ulët	7%
II	Erozion i ulët	53%
III	Mesatar	31%
IV	I ashpër	9%


### Rrëshqitja e tokës

Rajoni i Anamoravës karakterizohet me një llojlojshmëri shumë të theksuar litostratigrafike dhe ka një përbërje të ndërlikuar tektonike të terrenit. Këtu janë të shprehura proceset e theksuara bashkëvepruese gjeologjike, të sjelljes së materialeve nga shpatina me formimin e sipërfaqeve të shpëlarjes së shpejtuar dhe të gërryerjeve, rrëkeve dhe me dukuri të shumta të rrëshqitjeve dhe të shembjeve të dheut, të bartjes së materialeve sterile.

### Masat parandaluese për erozionin

Edhe pse territori komunës së Gjilanit nuk karakterizohet si zonë me shkallë të lartë të erozionit, prapë se prapë është e nevojshme të ndërmerren masat e nevojshme për parandalimin dhe uljen e shkallës së erozionit gjatë zhvillimeve të reja. Në zonat ku mundë të shfaqet kjo dukuri është duhet të pyllëzohen dhe të ndërtohen barrierat aty ku është e nevojshme. Për të arritur këtë ndikuar në këtë drejtim duhet vepruar në:

- Ngritja e vetëdijes së komunitetit
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara
- Kontrolli i zhvillimeve në zonat ku shkalla e erozionit është më e lartë
- Ndërmarrja e masave të nevojshme gjatë ndërtimit të rrugëve në zonat rurale



## Llojet e erozionit - Komuna e Gjilanit

02/08/2023 8:55 AM

© MSc. Gjeografisë Amir REXHA



## BRESHËRI DHE ERËRAT

### Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri

Në territorin e komunës Gjilanit, shtrëngatat dhe breshëri janë dukuri e rrallë natyrore. Paraqitja e tyre me intensitet të ulët më së tepërmi ndodhë në pranverën e hershme dhe në vjeshtë. Rastet e paraqitjes së shtrëngatave dhe breshrit me intensitet të mesëm dhe të lartë janë të kohë-pakohshme edhe muajve të verës.



**Pullaze shtëpish të dëmtuara gjatë shtrëngatës dhe breshërit të vitit 2009**

Shtrëngatat të shoqëruara breshër në rend të parë reflektohen në rrezikimin e sigurisë së qytetarëve, dëmtimin e shtyllave elektrike dhe rrjetit të saj, rrjetin e telefonisë fikse dhe mobile, dëmtimi i pullazeve, dëmtimi i shtëpive nga materiali i dobët si dhe zhvendosjen e gjësendeve të forta e metalike të pa përforcuara e të cilat mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe kalimtarëve të rastit etj. Shtrëngatat dhe breshëri dëmet më të mëdha i shkaktojnë në sektorin e bujqësisë.

Ne dhjetë vjetshin e fundit, goditja më e rënd nga kjo fatkeqësi natyrore ka ndodhur me 24.05.2009. Rreth orës 15:20, një shtrëngatë e shoqëruar me breshër ka goditur pjesën veriperëndimore, perëndimore, qendrore, jugperëndimore dhe pjesërisht pjesën jugore të qytetit të Gjilanit. Në intervalin kohor 10 deri në 15 minuta sa ka zgjatur kjo shtrëngatë, përpos panikut, ka arritur të shkaktoj dëme të konsiderueshme në lagjet e qytetit: një pjesë të lagjes Dheu i Bardh, Dardaninë 1, Dardaninë 2, Qendra, Kodrën e Dëshmorëve, pjesërisht lagjen Arbëria, pjesërisht fshatin Livoq i Poshtëm, pjesërisht fshatin Livoq i Epërm dhe pjesërisht fshatin Velekincë

Sipas Komisionit mbi Dëmet e Shkaktuara të emëruar nga Kryetari i Komunës dëmet nga kjo fatkeqësi janë si më poshtë:

### Pasoja nga breshëri

	Sektorët e dëmtuar	Ek. Familjare Nr.	Tjegulla	Xhama m <sup>2</sup>	Fasada m <sup>2</sup>	Vetura	Trupa të pemëve	Kopshte m <sup>2</sup>	Vlera €
1	Ek. familjare	6.205	2.236.856	5.009	27.816	1.691	38.402	14.6985	2.128.464
2	Banesa kolektive								105.160
3	Shëndeti primar		5.300						2.120
4	Spitali regjional								60.000
5	Bujqësia								1.280.508
6	Biznesi		79.653	152	370	47			41.021
Σ		6.205	2.321.809	5.161	28.186	1.738	38.402	146.985	3.617.274

Shpeshësia e paraqitjes dhe muajt kritik

Breshëri	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
					√	√						

Masat parandaluese për shtrëngata dhe breshër

Zhvillimet tekniko teknologjike kanë bërë të mundur që shtrëngatat dhe breshëri si fenomen natyror të kenë mundësin e paralajmërimit. Ndër masat që duhet të merren për zvogëlimin e dëmeve nga ky fenomen natyror janë

- Ndërtimet e objekteve të banimit dhe ekonomike në përputhje me rregullat e ndërtimit;
- Inspektimi dhe mbikëqyrja e gjendjes së objekteve nga inspektorati i ndërtimit;

## ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË

## Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale

Stacioni Gjilan	Veriu (N)		Verilindje (NE)		Lindje (E)		Juglindje (SE)		Jugu (S)		Jugperëndimi (SW)		Perëndimi (W)		Veriperëndim (NW)		C
	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	R‰	m/s	
	251	1.47	233	1.77	15	1.8	90	2.1	29.7	1.8	72.3	1.47	93	1.43	154	1.23	

## Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Nga historiku i goditjes së erës në komunën e Gjilanit, pjesa më e goditur është zona veriperëndimore e komunës, e cila përfshinë lagjen Dardania të qytetit, fshatrat Livoç i Epërm, Muhaxhirët e Poneshit, Myhyrtë, Poneshin dhe Bresalcin, vendbanime këto me rreth 10.000 banorë. Goditja e fundit ka ndodhur me 21-22 qershor 2022, me një intensitet prej 23 m/s, ku janë shkaktuar dëme në infrastrukturën e transportit të energjisë elektrike, të telefonisë dhe internetit, pullaze të shtëpive dhe bizneseve, sera dhe pemishte. Viktima në njerëz nuk ka pasur.


Në përmasa më të vogla, kohë pas kohe, është goditur edhe zona në mes të qytetit të Gjilanit dhe fshatit Malishevë,

Dëmet nga goditja e erës me 22-23 qershor 2022	Shtylla elektrike	Pullaze të shtëpive	Pullaze të bizneseve	Sera	Pemishte	Lisa
	8	3	2	6	1	3

Erërat në muajt kritik	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
						√	√					



Goditja e erës në Komunën e Gjilanit me 21 dhe 23 qershor 2022




Harta e historikut të goditjes së erës në komunën e Gjilanit

### Masat parandaluese nga erërat

Zhvillimet tekniko teknologjike, kanë bërë të mundur që errat si fenomen natyror, të kenë mundësin e paralajmërimit. Ndër masat që duhet të merren për zvogëlimin e dëmeve nga ky fenomen natyror janë:

- Ndërtimet e objekteve të banimit dhe ekonomike në përputhje me rregullat e ndërtimit;
- Inspektimi dhe mbikëqyrja e gjendjes së objekteve nga inspektorati i ndërtimit;





## Shpejtësia e erës m/s - Komuna e Gjilanit

02/08/2023 8:55 AM  
© MSc. Gjeografisë Amir REXHA

## THATËSIRAT


### Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike

Thatësira në komunën e Gjilanit, kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe shkaktojnë rrezik kryesisht në furnizimin me ujë dhe në rendimentet bujqësore. Furnizimi me ujë në komunën e Gjilanit kryesisht bëhet nga liqeni akumulues i Përlepnicës dhe pusët nëntokësore, që gjithashtu varën nga të reshurat atmosferike, sasia vjetore e të cilave arrinë 603.7 mm<sup>18</sup>.

Në 20 vitet e fundit, kemi të evidentuar thatësi ekstreme në vitin 2015 dhe në vitin 2019, ku liqeni akumulues i Përlepnicës ka rënë në pikën kritike, gjë që ka vështirësuar furnizimin me ujë për Komunën e Gjilanit.

Gjithashtu, për shkak të ndryshimeve demografike, kapacitetet ekzistuese të akumulimit, janë të pa mjaftueshme për të akumuluar sasi të mjaftueshme për të furnizuar me ujë banorët e komunës së Gjilanit.

Kërkesa e përgjithshme për ujë në Gjilan, nga viti 2013, fillon të rritet dukshëm dhe nga kjo periudhë, fillon paraqitja e deficitit për ujë. Deficiti i ujit nga ky vit është 50. l/s, që do të thotë se nga kjo periudhë, qyteti duhet të mendoj seriozisht në gjetjen e burimeve shtesë dhe afatgjate për Gjilanin. Nga viti 2013, e deri në vitin 2022, kërkesa për ujë rritet vazhdimisht përkundër planifikimit të humbjeve në sistemin e ujësjellësi, kështu që në vitin 2022, deficitin për ujë të pijes për Gjilan kalon sasinë prej mbi 100. l/s.



<sup>18</sup> Institutit Meteorologjik të Kosovës, 2023.

Sa i përket dëmeve, në këto tridhjetë vitet e kaluara, nuk ka të evidentuara dëme si dhe humbje të njerëzve si shkak i thatësisirave. Ndërkohë, nga fakti se gjithë banorët e komunës, bizneset dhe institucionet furnizohen nga liqeni akumulues i Përlepticës, dhe nga të njëjtat vendburime nëntokësore, rreziku nga thatësia përfshinë pjesën më të madhe të komunës.

#### **Rezervuarët e ujit:**

Sipas gjendjes ekzistuese të përshkruara në raportet sektoriale për infrastrukturën teknike të ujësjellësit dhe në raportet e KRU Hidromorava, kapacitetet e rezervuarve të ujit për furnizimi me ujë të pijshëm për qytetin e Gjilanin dhe fshatrat përreth me të cilat menaxhon KRU Hidromorava arrin vëllimin prej **V=7265m<sup>3</sup>** ujë . Rezervuarët e ujit furnizojnë qytetin e Gjilanit dhe 9 fshatra (vendbanime rurale).

#### **Masat parandaluese për shfrytëzimin joracional të ujit:**


- A. Kujdesi ndaj ambientit;
- B. Vedisimi i popullsisë për shfrytëzimin racional të ujit;
- C. Zbatimi i masave ndëshkuese për keqpërdoruesit e ujit;
- D. Ndërtimi i një liqeni akumulues;
- E. Zbatimi masave mbi kursimin e ujit.
- F. Në rast të thatësisë, ndalimi i shfrytëzimit të ujit nga rrjeti i ujësjellësit i shfrytëzuesve të mëdhenj (autolarjet dhe industria);
- G. Identifikimi i puseve dhe burimeve alternative ku qytetarët mund të furnizohen me ujë

#### **Në rast të thatësive të bëhet furnizimi alternativ i qytetarëve me ujë:**

- A. Sigurimi i mjeteve – cisternave ekzistuese për transport dhe shpërndarje të ujit të pijshëm dhe teknik në tërë hapësirën e Komunës së Gjilanit.
- B. Blerja ose kontraktimi i operatorve që ofrojnë cisterna shtesë
- C. Përcaktimi i lokacioneve të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe industrial dhe vendosja e depozitave të ujit sipas nevojës;
- D. Përcaktimi i orarit të furnizimit.

#### **Masat parandaluese të përhapjes së sëmundjeve dhe epidemive në rast thatësie:**

- A. Kontrolle të inspeksionit në industrinë përpunuese, që si lëndë të parë shfrytëzon lëndë organike (industria ushqimore)
- B. Kontrolli i vazhdueshëm i Shëndeti Publik i restoranteve dhe hapësirave të tubimeve masive të qytetarëve
- C. Kontrolli i vazhdueshëm i ujit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.



### Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale

Komuna e Gjilanit për shkak të pozitës gjeografike dhe klimës, nuk njihet si zonë karakteristike që favorizon kushtet e zhvillimit të endemive dhe të epidemive. Mirëpo, gjithashtu, për shkak të pozitës gjeografike, si zonë kufitare me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe për shkak të lidhjeve të shumta me mërgatën, i nënshtrohet rreziqeve të bartjes së viruseve që përhapin sëmundje ngjitëse që shkaktojnë epidemi, e në vitet e fundit u ekspozuam edhe nga pandemia COVID 19.

### Situata epidemiologjike në komunën e Gjilanit karakterizohet<sup>19</sup>:

Sipas statistikave që i kemi ndër vite, sëmundjet ngjitëse që raportohen në Qendrën Regjionale të Shëndetit Publik – Gjilan (QRSHP) nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), si dhe nga reparti Infektiv dhe Pediatrik i Spitalit Regjional, janë:

- ✓ Sëmundjet ngjitëse të zorrëve-Diaretë akute dhe Gastroenteritet akute,
- ✓ Sëmundjet respiratorë me theks te veçantë Gripi (ILI), e sidomos pas pandemisë së COVID-19, rastet Gripit po raportohen edhe jashtë sezonës së Gripit (muajve të verës),
- ✓ Rastet me COVID-19, krahasuar me vitin e kaluar 2022, gjatë periudhës 6-mujore të vitit 2023 kemi rënie të raportimit, kurse në muajt e fundit nuk kemi fare raportim të këtyre rasteve, krejt kjo, duke ju falënderuar vaksinimit .
- ✓ Rastet me sëmundjen e Tuberkulozit raportohen nga ATD-ja dhe krahasuar me vitet e pasluftës, kemi një rënie të raportimit të këtyre rasteve në komunën tonë, ku në vitin 2019, nga Gjilani kishim 21 raste, ndërsa në 2022 kemi 12 raste të reja me TBC të raportuara.
- ✓ Sëmundjet zonotike që e karakterizojnë vendin tonë në përgjithësi por edhe komunën e Gjilanit janë Brucelloza dhe Tularemia.

Derisa këto dy sëmundje pas luftës lajmëroheshin me numër të madh të rasteve e edhe me epidemi familjare, viteve të fundit kemi rënie të raportimit të këtyre rasteve, ku raste të Tularemisë nuk kemi të raportuara që nga viti 2018.

- ✓ Brucelloza edhe pse me rënje të numrit të rasteve të raportuara nga komuna e Gjilanit, për shkak të lajmërimit të brucelozës në kafshë, kemi paraqitjen e rasteve sporadike, por duke ju falënderuar punës së Shërbimit Veterinar ,kemi rënie të raportimit të këtyre rasteve humane, por gjithmonë duke i mbikëqyrur zonat endemike nga ana e ekipeve tona të terrenit në parandalim të paraqitjes së këtyre rasteve te brucelozës.

<sup>19</sup> Dr.Burbuqe Shkodra-Epidemiologe, “Qendrën Regjionale të Shëndetit Publik – Gjilan” 02.10.2023.

Sëmundjet ngjitëse në komunën e Gjilanit	2021		2022	
	Rastet	Morbiditeti	Rastet	Morbiditeti
Pneumonia	285	142,5	322	166
SARI (Infek.ac.respir.të rënda)	0	0	0	0
Diarrea akute	2.954	1.477	3.332	1.666
Varqella	203	101,5	243	121,5
Dyshimi në Influençë ( ILI )	2.189	1.094,5	4.479	2.239,5
COVID-19 (SARS-CoV-2)	6.856	3.428	7.545	3.772,5
Dyshimi në Tuberkuloz	30	15	28	14
Hepatit ac. "C"	0	0	1	0,5
Pickim nga rriqëra	0	0	25	12,5
Brucelloza	0	0	2	1
IST (Neisseria Gonorrhoea)	0	0	1	0,5
Sindromi i Diarresë me gjak	4	2	8	4
<b>Gjithsej</b>	<b>12.521</b>	<b>6.260,5</b>	<b>15.996</b>	<b>7.998</b>



#### Situata epidemiologjike në Regjionin e Gjilanit 2022 - 2023

#### Pandemia COVID – 19, historiku:

Me 22.03.2020, Qendra Regjionale e Shëndetit Publik, njofton për infeksion me COVID-19 të dy qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Njëri nga të infektuarit e gjinisë femër nga fshati Vrapçiç, e ardhur nga Gjermania, dhe një nga fshati Zhegër

Masat e perballimit të situatës:

1. Kryetari i komunës ka aktivizuar Planin Operativ Emergjent;
2. Është formuar Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe është aktivizuar Qendrës Operative Emergjente;
3. Është izoluar zona, është bërë historia e lëvizjes së përsoanave të infektuar dhe janë dërguar për testim në Institutin e Shëndetit Publik;
4. Nga testimi kanë rezultuar pozitiv 13 qytetarë të fshatit Vrapçiç dhe 14 negativ;
5. Nga personat në fshatin Zhegër ka rezultuar 1 person pozitiv, dhe 50 negativ;
6. Fshati Vrapçiç dhe Zhegër janë izoluar. Personat e infektuar janë izoluar dhe futur në tretman mjekësor, personat që kanë kontaktuar të infektuarit janë izoluar;
7. Ka filluar trajtimi i zonave të izoluar me artikuj ushqimor, higjenik dhe medikamente për banorët e zonave të izoluar;
8. Ka filluar mbështetja me pako ushqimore dhe higjenike për rastet sociale.
9. 09.04.2020, si pasoj e COVID-19, në fshatin Vrapçiç kemi një person të vdekur i moshës 72 vjeçare.



Deri me 28.09.2022, si rezultat i goditjes së pandemisë COVID-19, mbi bazë të rezultateve të Qendrës së Regjionale të Shëndetit Publik dhe Qenres Operative Emergjente të Komunës së Gjilanit, rezultojn:

Gjithsej të infektuar.....17.351;  
 Të shëruar.....17.142;  
 Të vdekur.....209;  
 Raste aktive.....0;  
 Teste të realizuara..... 37.274.

## Mësimet e mësuara nga menaxhimi i pandemisë COVID-19

Mënyra më efikase për të përballuar situata emergjente është që institucionet e gjitha niveleve, paraprakisht, të kenë të hartuara dokumentet bazike – plane për përballimin e situatave.

Para se të ndodhë pandemia COVID-19, komuna e Gjilanit i kishte të miratuara nga Kuvendi i Komunës dokumentin “Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera” si dhe “Planin Operativ Emergjent”. Operacionet gjatë pandemisë kanë konfirmuar rëndësinë e këtyre dokumenteve, të cilat edhe nëse kanë ndonjë mangësi, ato përsëri janë instrumenti adekuat përmes të cilit përcaktohet hierarkia që menaxhon me incidentin, si dhe standardizohen - koordinohen veprimet me institucionet relevante të përfshira në incident.

Mbi bazë të këtyre dokumenteve ka filluar operimi:

1. Vendimi për aprovimin e Planit Operativ Emergjent;
2. Vendimi për themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim;
3. Vendimi për themelimin e Qendrës Operative Emergjente (QOE).

Pasi është themeluar QOE, është hartuar Plani i Veprimit, i cili ka përfshirë shtyllat themelore mbi bazë të së cilave është operuar gjatë pandemisë:

- Kapacitetet mjekësore publike dhe private;
- Lokacionet e karantinës;
- Databaza e personave të infektuar me virusin Covid-19;
- Lista e personave në nevojë;
- Lista enciale e ushqimit, mjeteve higjienike dhe ekipa e shpërndarjes;
- Lokacioni i deponove të ndihmave humanitare;
- Mjetet motorike të mobilizuara nga QOE;
- Mirëmbajtja dhe dezinfektimi i rrugëve, hapësirave publike dhe shesheve;
- Identifikimi i personave me historinë e lëvizjes në zonat e prekura nga virusi Covid-19;
- Lista dhe lokacioni i barnatoreve kujdestare;
- Lista e bizneseve-furrave lidhur me furnizimin me bukë për qytetarë.

### **Rekomandimet:**

1. Ndërtimi sipas standardeve dhe funksionalizimi i Qendrës Operative Emergjente;
2. Mirëmbajtja periodike e Planeve Operative
3. Ushtrimet periodike fushore dhe në tavolinë të skenarëve të hartuar për incidente nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera;
4. Hartimi i databazave të personelit shtesë për reagime në incidente, të resurseve teknike për angazhim, të deponive për rezerva ushqimore dhe mjekësore.

### Forma standarde e grumbullimit e të dhënave, vlerësimit të gjendjes dhe veprimit gjatë pandemisë COVID-19

Kategoria e rrezikut	Shëndetësor		<b>COVID-19</b>												
Lloji	Pandemi														
Rreziku	I vazhdueshëm														
Lokacioni	Vrapçiq - Zhegër														
<b>Historiku – gjendja fillestare</b>	<p>Me <b>22.03.2020</b>, Qendra Regjionale e Shëndetit Publik, njofton për infeksion me COVID-19 të dy qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Njëri nga të infektuarit e gjinisë femër nga fshati Vrapçiq, e ardhur nga Gjermania, dhe një nga fshati Zhegër</p> <p>Masat e përballimit të situatës:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryetari i komunës ka aktivizuar Planin Operativ Emergjent;</li> <li>2. Formimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Qendrës Operative Emergjente;</li> <li>3. Është izoluar zona, është bërë historia e lëvizjes së personave të infektuar dhe janë dërguar për testim në Institutin e Shëndetit Publik;</li> <li>4. Nga testimi kanë rezultuar pozitiv 13 qytetarë të fshatit Vrapçiq dhe 14 negativ;</li> <li>5. Nga personat në fshatin Zhegër ka rezultuar 1 person pozitiv, dhe 50 negativ;</li> <li>6. Fshati Vrapçiq dhe Zhegër janë izoluar. Personat e infektuar janë izoluar dhe futur në tretman mjekësor, personat që kanë kontaktuar të infektuarit janë izoluar;</li> <li>7. Ka filluar trajtimi i zonave të izoluar me artikuj ushqimor, higjienik dhe medikamente për banorët e zonave të izoluar;</li> <li>8. Ka filluar mbështetja me pako ushqimore dhe higjienike për rastet sociale.</li> <li>9. 09.04.2020, si pasojë e COVID-19, në fshatin Vrapçiq kemi një person të vdekur i moshës 72 vjeçare.</li> </ol>														
	<b>Gjasa</b>	<p style="text-align: center;">↓</p> <p><b>EFEKTI:</b></p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td style="background-color: white;">I ulët</td> <td style="background-color: white;">I ngritur</td> <td style="background-color: yellow;">I mesëm</td> <td style="background-color: blue;">Serioz</td> <td style="background-color: red;">Katastrofë</td> </tr> </table>										I ulët	I ngritur	I mesëm	Serioz
I ulët		I ngritur	I mesëm	Serioz	Katastrofë										
<b>Goditja</b>	<b>Banorë</b>		<b>Familje</b>		<b>Hendikap</b>		<b>Femra</b>		<b>Meshkuj</b>						
	Zhegër	Vrapçiq	Zhegër	Vrapçiq	Zhegër	Vrapçiq	Zhegër	Vrapçiq	Zhegër	Vrapçiq					
	3327	290	665	58	12	2	1675	128	1652	162					
<b>Pasojat</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërprerja e aktiviteteve të përditshme ekonomike, arsimore, kulturore, sportive, fetare në gjithë territorin e Komunës së Gjilanit;</li> <li>2. Krijimi i frikës dhe panikut;</li> <li>3. Shkaktimi i dëmeve ekonomike në veprimtaritë private ekonomike;</li> <li>4. Krijimi i shpenzimeve të pa planifikuara të komunës për përballimin e pandemisë</li> </ol>														



## FATKEQËSITË TJERA

### **Liçeni akumulues i Përlepnicës**

Njëra nga pikat kritike që mund të shkaktoj rrezik të nivelit katastrofë në rast të ndonjë avarie, është nëse shpërthen diga e liçenit akumulues të Përlepnicës.

Diga e liçenit të Përlepnicës ka filluar të ndërtohet në vitin 1977, në rrjedhën e lumit Perlepnica. Diga është ndërtuar nga materiali rrethor i marruar në afërsi të akumulacionit, bërthamë nga argjila ndërsa dy shtresa të tjera me gurët rrethorë. Punët përfunduan në vitin 1982, ndërsa pas dy viteve të përfundimit të punëve në ndërtimin e digës është intervenuar me injektimin e pjesës së majte të tokës me perde injektuese ( $h=40m$ ).

### **Karakteristikat kryesore e trupit të digës:**

- Lartësia e trupit të digës nga kuota e fundit  $H=44$  m;
- Lartësia e trupit të digës nga kuota e ternit  $H=40$  m;
- Kuota e kurorës së digës 599, lartësi mbi detare (lmd):
- Kuota maksimale e nivelit të ujit 598, lmd
- Kuota e nivelit të ujit në akumulacion 596, lmd:
- Kuota e fundit të ujit 556, lmd
- Vëllimi i trupit të digës  $190.825$  m<sup>3</sup>;
- Vëllimi maksimal i ujit në akumulacion 4 milion m<sup>3</sup>;
- Vëllimi normal i ujit 3.6 milion m<sup>3</sup>;
- Gjerësia e kurorës së digës 8.00 m;
- Gjatësia e trupit të digës 165 m;

### **Karakteristikat kryesore e akumulacionit:**

- Kuota maksimale e nivelit të ujit 598, lmd
- Kuota e nivelit të ujit në akumulacion 596, lmd
- Kuota e fundit të ujit 556, lmd
- Vëllimi maksimal i ujit në akumulacion 4 milion m<sup>3</sup>
- Vëllimi normal i ujit 3.6 milion m<sup>3</sup>
- Vëllimi shfrytëzues i ujit në akumulacion 2.62 milion m<sup>3</sup>
- Vëllimi i pashfrytëzuar apo i vdekur 0.94 milion m<sup>3</sup>
- Sipërfaqja e pasqyrës së ujit 18.24 ha
- Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të akumulacionit 62.0 km<sup>2</sup>


Në kuadër të akumulacionit dhe trupit të digës me qëllim të evakuimit të ujërave të mëdha është ndërtuar kaparderdhja, e cila ka kapacitet të largimit të ujërave deri  $274$  m<sup>3</sup>/.

Përpos kaparderdhjes e cila ka të bëjë me evakuimin e ujërave të mëdha, në kuadër të trupit të digës janë edhe galeria evakuese, përmes të cilës planifikohet largimi i sasisë prej  $59$  m<sup>3</sup> ujë, sasi e cila mund të ndodhe një herë në 20 vjet.

Si alternativ tjetër për zbrazjen e ujit në rast avarie apo fatkeqësie, janë edhe gypi Ø800 mm., që është i vendosur në kullën për kaptimin e ujit, përgjatë galerisë evakuse dhe që pranon sasinë e ujit në tri nivele te ndryshme:

- niveli i parë i kaptimit të ujit është në kuotën 588 lmd, apo 8m nën nivelin normal te ujit;
- niveli i dytë i kaptimit është në kuotën 579 lmd, apo 9m nën nivelin e kaptimit të parë;
- niveli i tretë i kaptimit të ujit është në kuotën 572 lmd, apo 7m nën nivelin e kaptimit të dytë.

Zbrazja e ujit nën kuotën 560.60 që konsiderohet si hapësira e vdekur mundësohet përmes gypit nga çeliku i derdhur të profilit Ø 400mm.



**Liçeni akumulues i Përlepnicës**



**Distanca e digës me fshatin Përlepnice**

### **Skenari për pasojat nga shpërthimi eventual i digës hidro-akumuluese**

Duke ju referuar Elaboratit në rast të shkatërrimit të trupit të digës, vërehet se banorët të cilët jetojnë në pjesë e poshtme të akumulacionit janë të rrezikuar drejtpërdrejt në rast të avarisë apo shkatërrimit të trupit të digës së Perlepnicës.

Sipas profilit të paraqitur në elaborat, vendbanimet të cilat janë drejtpërdrejt të atakuar në rast shkatërrimit të digës janë:

- Fshati Perlepnice, i cili ndodhet në mes gjatësive 0.9 km - 2.2 km;

- Fshati Kmetoc, i cili ndodhet në mes gjatësive 3.8 km, dhe
- Fshati Doberqan, i cili ndodhet në mes gjatësive 7.8 km- 8.2 km.

Në bazë të këtyre profileve dhe duke u bazuar në modelimin hidraulike është caktuar edhe vala goditëse në rast të shkatërrimit të trupit të digës. Modelimi hidraulik është bërë për dy variante:

- a. Kur vala goditëse është bazuar në nivelin maksimal të ujit në liqe dhe shkatërrimit masiv të trupit të digës në rast avarie, apo tërmeti shkatërrues ( $Q = 278.7 \text{ m}^3/\text{s}$ ), dhe
- b. Kur vala goditëse është e bazuar në nivelin normal dhe kur  $Q = 0.34 \text{ m}^3/\text{s}$

#### **Varianti a:**

Për ta parashikuar drejtpërdrejtë rrezikun e banorëve në vendbanimet të cilat gjinden nën trupin e digës, është analizuar edhe koha e goditjes së valës goditëse.

1. Në bazë të rezultateve, vala goditëse në hyrje të fshatit Përlepnice, e cila është në gjatësinë  $L = 900 \text{ m}$  nga trupi i digës, do të arrijë në kohën prej 35 sekonda.
2. Në hyrje të fshatit Kmetoc, e cila ka gjatësi nga trupi i digës  $L = 3200 \text{ m}$ , vala goditëse në rast të shkatërrimit të pendës do të arrijë në kohën prej 420 sekonda ose 7 minuta të plota.
3. Në hyrje të fshatit Dobërqan, gjatësia e të cilit nga trupi i digës është  $L = 7800 \text{ m}$ , vala goditëse do të arrijë për 1150 sekonda, ose 19 minuta e 16 sekonda.

Nga ky rezultat mund të konkludohet se në rast të shkatërrimit të digës së Përlepnice, në të cilën kuota e nivelit të ujit është maksimale dhe sasia e ujit që kalon në valën goditëse është  $278.7 \text{ m}^3/\text{s}$ , mundësia e evakuimit nga përmbytjet do të mund të bëhet vetëm në fshatin Dobërqan, ku koha e goditjes së valës është relativisht e gjatë afër 20 minuta, ndërsa dy vendbanimet e tjera, sidomos fshati Përlepnice gati do të jetë i pa mundur evakuimi i njerëzve, ngase koha prej 35 sekonda është shumë e shkurtër për t'u mobilizuar edhe për t'u larguar nga zona e rrezikut.

#### **Varianti b:**

Në bazë të rezultateve të këtij varianti kemi:

1. Vala goditëse në hyrje të fshatit Përlepnice do të arrijë në kohën prej 120 sekonda apo 2 minuta të plota;
2. Në hyrje të fshatit Kmetoc, vala goditëse do të arrijë në kohën prej 655 sekonda ose 11 minuta e 31 sekonda;
3. Në hyrje të fshatit Dobërqan, vala goditëse do të arrijë për 1760 sekonda ose 29 min e 33 sekonda.

Edhe në këtë rast evakuimi i banorëve nga fshati Përlepnice do të ishte i pamundur për kohën e shkurtër 2 minuta, derisa nga dy fshatrat Kmetoc dhe Dobërqan, në raste alarmimi efikas, evakuimi do të ishte i mundur.

Për ta kuptuar shpejtuesin e lëvizjes së prurjes është arritur edhe ky rezultat:

- Për variantin e parë, ku kuota e nivelit të ujit është maksimale dhe sasia e ujit që kalon në valën goditëse është  $278.7 \text{ m}^3/\text{s}$ , uji lëvizë me shpejtësinë prej 90 km/h;
- Për variantin e dytë, kur niveli i ujit është në kuotën normale dhe kur  $Q = 0.34 \text{ m}^3/\text{s}$ , uji lëvizë me shpejtësinë prej 22.5 km/h.

Niveli i ujit në akumulacion, i cili në rast të shkatërrimit të digës do të bënte përmytjen e tri vendbanimeve të përmendura, ku do të mund të arrinte deri në kuotat:

- Për fshatin Dobërçan kuota 574,40 lmd;
- Për fshatin Kmetoc kuota 579.00 lmd dhe;
- Për fshatin Përlepnice kuota 582,80 lmd.



**Zona e rrezikut në rast të shpërthimit të digës së liqenit akumulues të Përlepnicës**

Sipas dokumentacionit dhe elaboreve që kanë të bëjnë me stabilitetin e trupit të digës, e që disponon KRU Hidromorava në Gjilan, që nga fillimi i punës së digës në vitin 1982, e deri në vitin 1996, stabiliteti i trupit të digës është përcjellë në mënyrë shumë profesionale. Nga elaboretet e asaj kohe është konstatuar se nuk ka ndonjë tregues që flet për rrezik të stabilitetin të trupit.

Duhet të theksohet se sipas literaturës teknike dhe rregulloreve në fuqi, për digat e tilla, duhet se paku një here në vite të behet matja gjeoteknike të stabilitetit të trupit dhe të konstatohet në mënyrë profesionale stabiliteti i saj.

Në digën e Perlepnice që nga viti 1996 e deri më sot ende asnjëherë nuk është bere matja e stabilitetit edhe pse brenda kësaj periudhe të gjatë kanë ndodhur ngjarje të cilat do të mund ndikonin negativisht në stabilitetin e pendës ku nga këto po veçojmë: bombardimet e NATO-s (1999) dhe tërmeti i vitit 2002 që goditi regjionin e Gjilanit me fuqi prej 5,3 ballë sipas Rihterit.

### **Liqeni akumulues i Livoçit**

Në pjesën perëndimore të Gjilanit ndodhet Liqeni i Livoçit, i cili ka një sipërfaqe prej rreth 7 ha dhe ligatina prej 1ha, cili gjendet 5 km largësi nga qendra e qytetit të Gjilanit. Liqeni i Livoçit është liqeni i dytë më i madh në rajon pas liqenit të Përlepnices, me kapacitet të grumbullimit prej 1 milion kub ujë. Mirëpo për shkak të mbushjes me aluvione të fundit të liqenit, kapaciteti aktual i ujit nuk është në nivelet 1 milion kub. Të dhëna për gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë e murit të digës së këtij liqeni, institucionet komunale nuk i posedojnë. Nga matjet përmes gjeoportalit, rezulton: Diga është e ndërtuar nga betoni, ka formë të gjysmëharkut me një gjatësi lineare prej 110 metra. Ndërsa nga matjet tona të përafërta, lartësia e murit të digës nga baza është 11.9 metra, gjerësia 1 metër dhe gjerësia e kurorës 1.8 metra.

Nga studimi i fizibilitetit, realizuar me 2022,<sup>20</sup> gjendja aktuale e liqenit është:

Gjatësia 700 m;

Gjerësia 200 m;

Sipërfaqe 70,000 m<sup>2</sup>;

Thellësia 3,60 - 3,80 m;

Perimetri 1,600 m’;

Një studim për nivelin e qëndrueshmërisë së digës, përmasat e rrezikut në rast të shpërthimit të saj, nuk ekziston. Por, nga pozicioni në të cilin ndodhet ky liqe, në rast të shpërthimit të digës me sasi të ujit në kuotën maksimale, shkakton **rrezik të ashpër** të zonës së parë dhe të dytë të shtëpive të fshatit Livoç i Epërm dhe Livoç i Ultë, si dhe të tokave bujqësore poshtë fshatit Livoç i Ultë dhe të fshatit Budrikë e Poshtme, deri në derdhje në lumin Morava. Konstatimi për **rrezik të ashpër**, është bazuar nga historiku i vërshimeve, që shkaktohet në këtë zonë nga të reshurat e rëndomta dhe ato me intenzitet të lartë.

<sup>20</sup> Studimi i fizibilitetit: **Swisscontact** – Kompania Franceze GEODE, e kontraktuar nga Komuna e Gjilanit



Zona e rrezikut në rast të shpërthimit të digës së liqenit të Livoçit



## STRUKTURAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

### **Njësa Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit;**

- 23 zjarrëfiksa professional
- 4 zhytja professional
- 4 pjestar kërkim shpëtim

#### **Resurse teknike;**

- 7 kamiona
- 3 xhipa
- 1 barkë pa motor
- 8 pompa thithse për ujë

### **Shoqata e Vullnetarve të Zjarrfiksave**

Sekretar Ardit Hyseni, 043-570 -651

14 – vullnetar të angazhuar dhe të trajnuar

### **Konvikti i studentëve**

Menaxher i konviktit Gjilan, Fatos Qerimi pergjegjës 044125725;

Stafi:

- 2 kuzhinjerë;
- 1 ndihmës kuzhinjerë;
- 12 puntor të tjerë

### **Klubet alpiniste**

- Klubi Alpin Gjilan, kryetar Liridon Beqiri, të antarsuar ka 50 pjestar.  
Kontakti:048964446 [liridon.beqiri@rks-gov.net](mailto:liridon.beqiri@rks-gov.net) ;
- Shoqata Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste Kryetar Berat Isufi, të antarsuar ka 40 pjestar.  
Kontakti ; 049132490;
- Shoqëria Bjeshkatore Maja, kryetar Agim Kajtazi, të antarsuar ka 40 pjestar;  
Kontakti: 044125673, [agimkajtazi@hotmail.com](mailto:agimkajtazi@hotmail.com).



## KRYQI I KUQ I KOSOVËS – GJILAN

Sekretar: Ilmi Shala

Kapacitetet humane dhe teknike për intervenim dhe mbështetje;

Kapacitetet humane

1. Sekretari në cilsin e kordinatori të ekipës dhe zëvendësi i tijë
  2. Vlersimi i rrezikut 3 vullnetar.
  3. Strehim dhe menagjim të kampit 6 vullnetar.
  4. Ndhma e Parë 6 instruktorë.
  5. Edukim Shëndetsor të familjes 3 trajnere
  6. Psiko social 3 vullnetarë
  7. Mirqenje sociale (shpërndarja ndihmave) 15 vullnetar
  6. Rivënja e kontakteve familjare 2 vullnetar.
- Gjithsejt kapacitete humane 40.

Numri i kapaciteteve humane mund të rriter, varësisht prej kërkesës, duke u ndihmuar nga degët e Kryqit të Kuq të Kosovës të regjionit.

Kapacitetet teknike

1. Vetura Nisan Patrol
2. Dyshekë 30 copë
3. Batanije 90 copë
4. Shtreter fushor 20 copë

Kontakti: Rr. Villiam Shekspir, nr.55, Gjilan.

tel. +383 280 20507; +383 44238391, email, gjilan@redcross-ks.org



### **VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE – SPECIFIKE**

Vlerësimet përfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes dhe shpëtimit në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme, për tu përballur me pasojat e FNFT.

1. Pastrimi i lumenjëve në vlerë 100.000 euro;
2. Trajnimi bazik për zyrtarët komunal dhe punëtorët teknik të shkollave “Përdorimi i bombolave për fikjen fillestare të zjarrit” 300 euro;
3. Kontrata vjetore me Shoqatën e Zjarrëfiksve Vullnetar 94.296

Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent, trajnimin dhe aftësimin e tyre, përcaktimin e resurseve materiale të nevojshme, prioriteteve dhe drejtimeve të zhvillimit, si dhe definimin e procedurave standarde të operimit dhe monitorimit.

### **KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT**

Bartës i hartimit të Dokumentit Vlerësimi i Rrezikut ka qenë DMSH dhe drejtoritë komunale, ndërmarjet publike komunale, Kryqi i Kuq, Policia e Kosovës dhe nga kjo, hartimi i këtij dokumenti ka pasur kosto minimale të shpenzimeve.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Bazuar në dispozitat përfundimtare të rregullores nr 25/2022 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë, rishikimi pasues i dokumentit të vlerësimit për komunën e Gjilanit të bëhet çdo tre vjet, në raste specifike, sipas nevojës edhe më herët.**

### **REKOMANDIME:**

Në kuadër të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT për komunën e Gjilanit, grupi punues rekomandon, të:

1. Dokumenti i Vlerësimit të merret në konsideratë dhe për bazë gjatë hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
2. Hartojë programin (edukimin, trajnimin dhe vetëdijësimin qytetar) si dhe masat parandaluese për tri vitet e ardhshme;
3. Merret si bazë për analizimin e nevojave dhe fuqizimin e kapaciteteve reaguese;
4. Të hartojë skenarët dhe ushtrimin e tyre me qëllim të testimit të kapaciteteve reaguese humane dhe teknike;
5. Ndajë një fond për reagim emergjent bazuar në historikun e fatkeqësive për komunën e Gjilanit dhe vlerësimin e dëmeve dhe pasojave;

## Skenaret

<b>Skenari I</b>	<b>Vërshim</b>
<i>Frekuenca e ndodhjes:</i>	
<input checked="" type="checkbox"/> Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm ); <input type="checkbox"/> E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme); <input type="checkbox"/> Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); <input type="checkbox"/> I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);	
<i>Madhësia e mundshme:</i>	
<input checked="" type="checkbox"/> E papërfillshme (më pak se 10%) <input type="checkbox"/> E kufizuar( 10 deri 25%) <input type="checkbox"/> Kritike: 25 deri 50% . <input type="checkbox"/> Katastrofike: Më shumë se 50%	
<i>Lloji i skenarit:</i>	
<input checked="" type="checkbox"/> Skenari 1; <input type="checkbox"/> Skenari 2; <input type="checkbox"/> Skenari 3;	
<i>Ndikimi:</i>	
<input checked="" type="checkbox"/> I papërfillshëm; <input type="checkbox"/> I vogël ; <input type="checkbox"/> I mesëm ; <input type="checkbox"/> Katastrofike;	
Data e vlerësimit: <b>10.01.2021</b>	

Nr	Lumi	Vendi	Data		
		Lagjet Porodin, Fidanishte, Livadhet e Arapit, fshatin Malishevë	10.01.2021 08.h	11.01.2021 08h	tendenca
			Niveli në metra		
1.	Stanishorka		0.30	0.70	+0.90

### KONTEKSTI

Nr.	Parametrat:	Përmbajtja:
1.	<b>Vendi i ngjarjes (lokacioni)</b>	Komuna e Gjilanit, zona urbane e Gjilanit: Lagjet Porodin, Fidanishte, Livadhet e Arapit, fshatin Malishevë
2.	<b>Kushtet meteorologjike</b>	Më 10 – 11 janar 2021, gjatë natës kanë filluar reshje të shiut, të cilat në mëngjes dhe në mesditë kanë shtuar intensitetin. Gjatë mesditës, DMSH ka dal në teren për të shikuar nivelin e ujit në lumenjtë edhe përrenjtë e komunës, të cilët zakonisht dalin nga shtrati i tyre kur ka shtim të intensitetit të shirave. Gjatë vëzhgimit kemi vërejtur se sasia ujit është rritur. Për shkak të plastikës dhe hedhurinave tjera, janë zënë ujëlshesat dhe urat dhe ekziston mundësia që në vende të caktuara të shkaktohen vërshime në zonën urbane të Gjilanit dhe një pjesë të fshatit Malishevë.
	<b>Periudha e vitit:</b>	10.01.2021
	<b>Lloji i ditës:</b>	Ditë vikendi
3.	<b>Analiza meteorologjike për kohën</b>	Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Gjilanit. Për çdo dy vite kanë ndodhur vërshime, kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur 4 vërshime në zona të ndryshme, që dmth se për çdo të dytin vit kemi kemi pasur kërcënime nga vërshimet.(shëno ndonjë vit me vërshime të veçanta ). Në datë 12 janar 2021 ka filluar tërheqja e ujit në shtretërit e lumenjëve.
4.	<b>Popullata</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Pjesa urbane e qytetit të Gjilani: Porodini: 51 shtëpi, 204 banorë</li> <li>➤ Vishnjet: 53 shtëpi, 212 banorë</li> <li>➤ Livadhet e Arapit: 60 shtëpi, 240 banor;</li> <li>➤ Malishevë 42 shtëpi, 168 bonor</li> </ul>
5.	<b>Infrastruktura kritike ekzistuese</b>	Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi nuk ka pasur dëme të kufizuara. <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 2 pemishte.</li> <li>➤ Një serë</li> </ul>
7.	<b>Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)</b>	<p>- Pas njoftimit nga qytetarët dhe nga Policia e Kosovës, QOE (112), ka njoftuar DMSH dhe Njnesinë e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit për rritjen e nivelit të ujit në këtë zonë, por pa dëme.</p> <p>- DMSH, ka dalur në terren për të vëzhguar situatën, dhe pas informacioneve të grumbulluara nga Policia e Kosovës, nga njësitet e zjarrëfikësve, ka bërë vlersimin e situatës, ku ka vlerësuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjendja nuk mund të përkeqësohet, pasi sipas njoftimeve të Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, intenziteti i reshjeve do të pakësohet edhe ditën e nesërme të reshurat do të pushojnë;</li> <li>2. DMSH, përmes rrjetit të kryetarëve të lagjeve dhe fshatrave, përmes patrullave të policisë, ka kërkuar informacion shtesë për gjendjen përgjatë gjithë gjatësisë së shtratit të lumit Stanishorka;</li> </ol>

		-Pasi është njoftuar me gjendjen, DMSH ka vlerësuar se situata është e përballueshme dhe nuk ka nevojë të ndermirën veprime shtesë, përpos se janë noftuar operatorët e kontraktuar që të jenë në gadishmëri për ndonjë intervenim eventual.
8.	<b>Info plotësuese</b>	Në bazë të vlerësimit të gjendjes në terren, situata është e përballueshme nga njësitë emergjente komunale dhe nuk është e nevojshme të fillohet procedurë shpalljes së gjendjes emergjente
<b>INCIDENTI-NGJARJA</b>		
9	<b>Shkaku dhe shkaktari</b>	<p>Pas reshjeve intensive, institucionet lokale, unoftuan nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosoves (IHMK) me njoftim - komunikatë përmes faqes elektronike:  <a href="http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44">http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44</a>  <a href="https://ëëë.facebook.com/ihmk.rks/">facebook: https://ëëë.facebook.com/ihmk.rks/</a></p> <p>Informata paralajmëronte për reshje me intenzitet mesatar në zona të caktuara të komunës tonë:  - IHMK varësisht nga zhvillimet e cikloneve do të ofrojë njoftime me buletin meteorologjik, me qëllim që të mbahen të informuar institucionet dhe qytetarët me parashikimet meteorologjike.</p> <p>Gjendja e niveleve të ujit të lumit Stanishorka nga datë:  10.01.2021 08:00 – deri më 11.01.2021 08:00</p> <p>-Në disa segmente të lumit, ku janë të vendosura ujëlëshesa ju adekuate si dhe ura, përshkak të mbeturinave nga plastika dhe mbetjeve tjera, ekziston mundësia e daljës së lumit nga shtrati</p>
10	<b>Ngjarja kryesore</b>	<p>- Më: 11 janar 2021, uji i dalur nga shtrati përshkak të zënies së ujëlëshesave dhe urave, ka bërë një vërshim në disa oborre dhe sera.</p> <p>-Janë ndërmarrë masat për menjanimin e rreziqeve, ku përmes operatorve të kontraktuar, janë mënjanuar nga ujëlëshesat dhe urat mbeturinat e plastikës..</p>

		 <p>Rritja e nivelit të ujit në shtratin e lumit Stanishorka si shkak i mbylljes së urës nga plastika, drunjët dhe hedhurinat tjera shtëpiake</p>
11	<p><b>Pasojat primare dhe efektet anësore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëmtime të pjesëshme në dy sera me nga 100<sup>2</sup></li> <li>- Vërshimi i dy pemishteve në hapësirë rreth 700<sup>2</sup></li> </ul>
12	<p><b>Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti</b></p>	<p>Nuk ka pasur</p>

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

13	Rastet me fatalitet	-Nuk ka pasur;
14	Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;	Nuk ka pasur
15	Mungesë e nevojave elementare	- Si pasojë e vërshimeve: Deri sa është pastruar ura, për dy orë, është zhvilluar me vështërsi komunikacioni në drejtim të fshatit Malishevë.
16	Të evakuuarit	Nuk ka pasur
17	Ndikimi i përgjithshëm ekonomik	-Rreth 700 euro
18	Ndikimi në natyrë dhe mjedisi	
19	Ndërprerjet në jetën e përgjithshme	Përkohësisht është ndërprerë aksi rrugor Gjilan – Malishevë - Pogradjë
20	Humbje në trashëgimi kulturore	Jo
21	Implikime politike	Jo
22	Ndikimi i përgjithshëm	Rrezik i papërfillshëm

**PROBABILITETI-GJASAT**

23	Probabiliteti	- Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike,
24	Paralajmërimi i hershëm	-Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme për shkak të gjendjes së lumenjëve; -Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërim për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmëri; - Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose planin komunal për reagim emergjent (PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, ëb-faqe interneti, etj.
25	Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm	-Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit është ngrit gatishmëria për të papriturat dhe është aktivizuar Planifikimi Kontigjent për vërshimet, përmes të cilit është ngritur gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim;
26	Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes	-Faza akute e kësaj ngjarje ka zgjatur deri 12.01.2021. -Sipas vlerësimeve nga terreni, koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes brenda 24 orëve
27	Koordinimi	- Me Institutin meteorologjik të Kosovës, nga i cili merren të dhëna mbi parashikimin e motit. -Bazuar në informacionet nga terreni nuk është aktivizuar QOE e komunale dhe Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij. -Koordinimi i aktiviteteve është realizuar nga DMSH -Eshtë aktivizuar Komisionit për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve eventuale
28	Informata plotësuese	

## Probabiliteti/Gjasat:



